Biblioletra

REVISTË E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

VITI 2 • NUMËR 2 • QERSHOR 2005

# BKUK PO HYN NË RRJETIN NDËRKOMBËTAR TË INFORMACIONIT BIBLIOTEKAR




Automatizimi i shërbimeve të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare por edhe i bibliotekave të tjera në Kosovë tash e tutje do të jetë prioritet, për të nxënë trendet e zhvillimeve bashkëkohore bibliotekare – trende këto që lidhen me nevojat që kanë përdoruesit në nivel global. Përdoruesi i sotëm kërkon me ngulm informacione sa më të gjera – tej hapësirave të tij gjeografike, nacionale a rajonale – pra kërkon të drejtën të shfrytëzojë cilindo informacion, i cili prodhohet kudo qoftë ai.

BKUK, në këtë kontekst, po bën përpjekje të vazhdueshme që të bëhet pjesë në grupin e bibliotekave me shërbime të rregulluara të informacionit - t'i ofrojë, së pari, përdoruesit vendës, informacione të vlefshme lidhur me zhvillimet në fushat e ndryshme të dijes e të kulturës, e së dyti, t'i ofrojë edhe përdoruesit global, informacione lidhur me Kosovën dhe shqiptarët.

Përpjekjet e BKUK në automatizimin e shërbimeve të saja, kanë rezultuar me disa faza parapërgatitjeje, si: pajisja e stafit profesional me kompjuter dhe trajnimi i tyre në përdorimin e disa programeve të kompjuterit. Pastaj, kjo fazë e trajnimeve ka pasuar me përcjelljen e kurseve të gjuhës angleze nga stafi profesional.

Këto kanë qenë disa nga parakushtet, që i kanë paraprirë blerjes së programit kompjuterik Aleph 500 nga kompania Ex Libris, si dhe nisjes për implementimin e tij. Ky program që është strumbullari i të gjitha shërbimeve bibliotekare tashmë do të forcohet edhe me implementimin e Kodit të Sigurisë së Librit nga kompania RFID.

## BKUK NË FAZAT INTENSIVE TË IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT ALEPH 500

BKUK ka arritur që me sukses të përfundojë një pjesë të trajnimeve në përdorimin e programit Aleph 500 të bëra nga kompania Ex Libris. Trajnimet të cilat janë kryer përfshijnë: Trajnimin për Administrimin e Sistemit, i cili ka zgjatur prej 5 deri më 7 prill 2005; Trajnimi për përdorimin e Modulit të Katalogimit dhe të Katalogut në Internet - prej 18 deri 22 prill 2005, si dhe trajnimi për përdorimin e Modulit të Pasurimit, i cili ka zgjatur prej 30 deri më 3 qershor 2005.

/ vijon në faqen 8 /

# BKUK ndihmon riaktivizimin e Bibliotekës Përkujtimore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Në "Java e Bibliotekës në Kosovë", të organizuar në prill të vitit 2004, pati filluar projekti për riaktivizimin dhe pasurimin e Bibliotekës Përkujtimore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me literaturë të veçantë për këtë periudhë të lavdishme të historisë sonë kombëtare.

Me vendimin e drejtorit të BKUK-së, Dr. Sali Bashotës, për ta realizuar këtë projekt, u caktua një ekip prej tre punëtorësh nga BKUK-ja, i cili menjëherë filloi të punojë për realizimin e këtij projekti. Ekipi, qysh në fillim, realizimin e këtij projekti, të rëndësishëm, e ka konceptuar në disa faza, për të vepruar në mënyrë efektive, si: njoftimi me gjendjen e koleksioneve në Bibliotekën Përkujtimore të LSHP-së; hulumtimi i literaturës përkatëse në BKUK dhe tërheqja nga fondi i titujve, që janë më shumë se një ekzemplar; përgatitja e listave me titujt e publikimeve monografike dhe periodike të tërhequra nga koleksionet e BKUK-së; kontaktet me institucionet dhe personalitetet e njohura të shkencës dhe të kulturës shqiptare nga fushat përkatëse, si dhe apeli përmes mjeteve të informimit drejtuar institucioneve dhe individëve për dhurimin e materialeve me interes për periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; hulumtimi i materialeve bibliotekare dhe arkivore, që i përkasin kësaj periudhe, nëpër institucione të ndryshme jashtë vendit.

Pas një pune, gati njëvjeçare, që është duke u vijuar me mbledhjen e këtyre materialeve të veçanta, për këtë bibliotekë, është arritur të grumbullohet një fond i pasur me tituj të zgjedhur nga kjo periudhë historike.

Fondi i grumbulluar përfshin 112 tituj të botimeve monografike dhe periodike me një sasi prej 263 njësish.

Këto materiale i janë dërguar Bibliotekës Përkujtimore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 9 qershor 2005, me rastin e shënimit të 127-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ky projekt do të vazhdojë me hulumtimin, me grumbullimin dhe me përpunimin e literaturës, nga kjo periudhë historike, për ta kompletuar me fond të rëndësishëm këtë bibliotekë, e cila do të ishte përfaqësuese për këtë tip të koleksionit bibliotekar.

GJ. BERISHA

**Në këtë numër**

Biblioletra

BKUK PO HYN NË RRJETIN NDËRKOMBËTAR TË INFORMACIONIT BIBLIOTEKAR

Autorësia e shkrimit.....3

Në kërkim të periodikut të vjetër (II).....6

Huazimi ndërbibliotekarë.....9

Qasje të kufizuara në përdorimin e.....10

Zgjedhja e materialeve bibliotekare.....13

Veprimtaria bibliotekare në Luginën e Preshevës gjatë viteve 1947 - 2005.....15

Restaurimi i materialit bibliotekar - i aplikueshëm në kushtet tona.....17

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS
THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

www.biblioteka-ks.org

**Botues:** BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Dr. Sali Bashota
**Këshilli redaktues:** Mr. Shukrie Rama, Bedri Gashi, Fazli Gajraku, Dr. Bahtie Gërbeshi-Zylfiu, Gjon Berisha
**Lektor:** Muhamed Çitaku • **Realizimi kompjuterik:** Hekuran Rexhepi
**Fotoreporter:** Bashkim Binaku
**Adresa:** Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë
**Tel:** ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

# Autorësia e shkrimit

## *Shkrimi - vetja, referencë e importuar, a plagjiaturë*

BEDRI GASHI

Në kontekstin e shkrimeve analitike bibliotekare, kërkohen edhe analiza për peshën dhe vlerat e botuara. Pa nxitur mohime dhe as pohime të paqëndrueshme profesionale, shihen përpjekje serioze për të krijuar literaturën periodike dhe monografike, por vërehen edhe disa nuanca të shmangies nga trajtimi origjinal i këtyre botimeve.

Hulumtimi dhe shkrimi profesional, i bazuar në një përvojë të caktuar, kërkon jo vetëm kurs origjinal, por edhe dëshmi konkrete të tij mbi bazën e zhvillimeve të reja të institucioneve bibliotekare vendëse dhe botërore.

Botimi i artikujve profesionalë nuk përmban fuqi vlerësuese nëse në të shprehen tendenca plagjiature, kopjimi dhe përshtatjeje. Kur hetohen këto raste, sidomos në botimet periodike, është i nevojshëm mosnjësimi profesional me paraqitjet e një bibliotekari/e të ri/re, që i mungon përvoja teorike e praktike e shkrimit profesional e i cili krahasohet a nivelizohet me artikulimet shkencore të një doktori të shkencës së bibliotekarisë, që për dhjetëra vjet ka punuar dhe ka hulumtuar nëpër seksionet më të rëndësishme të IFLA-s ose nëpër divizionet e Bibliotekës së Kongresit Amerikan, në bibliotekat angleze, gjermane, franceze etj.

Mosvlerësimi eventual profesional ka të bëjë edhe me mungesën e përvojës vlerësuese, artikuluese dhe studiuese të fenomeneve të caktuara brenda institucionit përkatës bibliotekar nga punonjësi bibliotekar. Mungesa preferenciale ka të bëjë edhe me mostrajtimin e një problemi, me të cilin dikush s'është marrë kurrë as praktikisht e as teorikisht. Në qoftë se po, atëherë unë do të mund të shkruaja për fenomenet astronomike, gjeografike dhe matematikore, por do të isha "një përfaqësues i dobët i vetvetes dhe i institucionit tim".

Shkrimet e sotme me tematikë bibliotekare nuk duhet të jenë sterile, jopraktike dhe jofunksionale, por duhet të përmbajnë elemente autentike, integruese dhe të besueshme profesionale e shkencore për zhvillimin e bibliotekave në Kosovë.

Paraprakisht, shkencëtarët e bibliotekarisë botërore kanë vënë bazat shkencore para se të lindë shumica prej nesh. Ata kanë hartuar standarde dhe rregulla bibliotekare për shërbime dhe për divizione të tëra bibliotekare, të cilat vazhdimisht evoluojnë e transformohen. Ato, gjithmonë trajtohen nga tabani i një përvoje shkencore, rizbatohen dhe rifuten vazhdimisht në përdorim. Ne mund t'i komentojmë ato. Ne mund t'i transmetojmë ato. Ne mund edhe t'i kritikojmë ato, por duke i njohur e studiuar thellësisht. Ka raste kur në ndonjë artikull a libër bibliotekar shfaqen edhe trajtime sipërfaqësore. Prandaj, nuk është shumë e udhës të trajtohen pa u studiuar si duhet njësimet ose mosnjësimet, pajtimet ose mospajtimet eventuale me referencat shkencore të një shkencëtari të bibliotekarisë botërore. Nëse po, atëherë te lexuesi do të lindin pikëpyetje lidhur me çështjet e vërtetësisë së elaborimit dhe të studimit të fenomenit përkatës. Këtu, domosdoshmërisht, kërkohet edhe plotësimi i disa parakushteve esenciale profesionale.

Siç lexohet sot dhe siç mund të shihet edhe nesër, tradita e gjatë, trashëgimia e bollshme, kujdesi i lartë shoqëror, kriteret e sakta vlerësuese, vizitat e shumta hulumtuese dhe studimet shkencore bibliotekare të SHBA-së dhe të vendeve evropiane, krijojnë një jobalancë krijuese ndërmjet nesh, për shkak të përkushtimit dhe kushteve të tyre të larta profesionale.

Për dallim nga hulumtuesit e rrallë vendës, të cilët kanë para vetes ca botime tematike bibliotekare, hulumtuesit dhe autorët e huaj, që merren me çështjet e bibliotekave, kanë para vetes qindra botime profesionale. Gjithsesi, do të ishte kënaqësi e madhe dhe e veçantë,



edhe për bibliotekarët e rinj kosovarë, që në momentin e parë të ndesheshin me informacione të bollshme profesionale për trajtimin e ndonjë çështjeje të rëndësishme, që lidhet me përdoruesin, koleksionet, informacionin, komunikimin, teknologjinë e sotme informative, si dhe bibliotekat e të gjitha tipave, si tempuj mjaft kompleksë të botës së qytetëruar.

Në saje të një vazhdimësie të tillë, sot, bartësit e veprimtarisë bibliotekare botërore konkurrojnë me ide, projekte dhe me trashëgimi të mirëfilltë. Forcimi i pozitës dhe i shfaqjes sonë në suazat e veprimtarisë bibliotekare botërore kërkon edhe shkollimin superior dhe të specializuar bibliotekar, i cili do të na orientonte dhe do të krijonte bagazhin nacional për prezantim të mirëfilltë të tërë veprimtarisë bibliotekare në Kosovë. Pra, do ta krijonte baraspeshën e nivelit të duhur profesional.

Në bazë të analizës për krijimin e qasjeve të reja në botën e literaturës bibliotekare, konsideroj se mënyra e krijimit të vlerave të veprimtarisë botuese bibliotekare në Kosovë, ende ngec për shkak të trajtimeve të shpejta dhe të "prerjeve cezariane joprofesionale".

Hulumtuesit, trajtuesit dhe autorët e rinj a të vjetër, të shkrimeve profesionale, nuk bën të pajtohen me shtrirjen e pakonsoliduar tematike të çështjeve bibliotekare, sepse brezat e nesërm mund të ankohen, siç mund të ankohemi ne sot, për mungesën e trashëgimisë së shkruar profesionale për zhvillimin e bibliotekave të djeshme të Kosovës.

Nëpër librat e rinj profesionalë, nëpër revistat e themeluara ose që mund të themelohen nesër, me karakter bibliotekar, të dhënat e pakorrigjuara dhe të marra eventualisht nga ndonjë përkthim oksidental a oriental, që flasin për probleme të caktuara të një vendi, nuk do të thotë se nuk mund të hetohen nesër si të tilla, sepse specifikat e zhvillimit të rrjetit bibliotekar në Kosovë konkurrojnë për një trajtim ndryshe dhe imponojnë një shtrirje origjinale.

Kënaqësia ime dhe e secilit prej nesh, do të jetë gjithnjë edhe më e madhe kur shkrimi hulumtues dhe jo vetëm hulumtues, për punën e bibliotekarit a për fenomenin e caktuar profesional radhitet, mbështillet dhe klasifikohet si paraqitje origjinale, si informacion i prekur dhe i testuar mirë nga anë të ndryshme profesionale, si pikë e veçantë hulumtuese, e cila shfaqet drejtpërdrejt edhe nga praktikat.

Në qoftë se jo, atëherë stihia dhe emocioni i paraqitjes profesionale do të zhveshet nga hulumtuesit e ardhshëm profesionistë, të cilët do të krahasojnë elemente të ndryshme profesionale, të huazuara a të pahuazuara, siç mund të ndodhë shpesh nga euforia e ndonjë bibliotekari, që pretendon të kapë tema, të cilat nuk i ka shijuar kurrë në praktikë e as në teori.

Prandaj, origjinaliteti i paraqitjes sonë do t'u shërbejë pozitivisht hulumtimeve dhe studimeve të ardhshme profesionale, të cilat na mungojnë shumë.

## ECJA NËPËR DIJET DHE PRAKTIKAT PROFESIONALE

Krijimi i vlerave profesionale në literaturën profesionale bibliotekare kërkon njohjen e informacionit paraprak dhe dëshminë e prekjes praktike dhe teorike. Kjo shpeshherë kushtëzohet nga disa faktorë të rëndësishëm profesionalë. Disa prej këtyre faktorëve u trajtuan edhe më lart, por për fillesat tona ndihet mungesa e literaturës së përkthyer, pamundësia e vizitave në bibliotekat e tjera botërore, mungesa e vullnetit të mirë hulumtues, mungesa e kapacitetit të duhur profesional dhe kufizimet e ndryshme shoqërore.

Plotësimi i këtyre mungesave, të cilat reflektojnë edhe në botimet e sotme profesionale, do të ndihmonin në eksplorimin, në gjurmimin dhe në krijimin e vlerave

profesionale, që do të trasonin çështje të ndryshme që preokupojnë BKUK-në dhe bibliotekat e tipave të ndryshme në Kosovë.

Për mua, nuk mjafton vetëm të shërbehemi me një fakt të vockël e të papeshë profesional, e pastaj të fillojmë trajtimin nga pozicionet inferiore profesionale. Përgjithësimi edhe i problemeve të trajtuara profesionale paraqet punë gjysmake dhe të paefektshme, që janë dritëshkurtra për historinë e shkrimeve bibliotekare në Kosovë.

Lind pyetja: - sa merremi ne me trajtimin e studimit praktik të qasjes në informacione konkrete, që ndryshe mund t'i quajmë studime të informacionit për përdoruesin, sa merremi ne me trajtimin e botimeve të veçanta të personave të shquar të kulturës, të letërsisë, të artit dhe të shkencës? (Këto tema trajtohen edhe në revistat dhe në tekstet e vendeve të tjera – nuk janë shpikje tona, sepse qëllimi i një publikimi është t'i ofrojë njohuri të caktuara dhe informacione të caktuara shtresave të përdoruesve).

Nga ky këndvështrim do të ishte shumë më efikase nxitja e debatit dhe ofrimi i kritereve të shkruara profesionale për departamentet e BKUK-së, si dhe nxitja e debatit për to në formë të bashkëbisedimit reciprok. Ky bashkëbisedim do të krijohej si rubrikë interesante në historinë e literaturës bibliotekare, ku lexuesi, përdoruesi dhe punonjësi bibliotekar pyet, ndërsa punonjësi i specializuar përgjigjet. Në numrin tjetër - punonjësi i specializuar pyet, për shembull: për modelin e krijimit funksional të shërbimit, të sektorit dhe të departamentit, apo të modulit, që tash na imponohet, me sistemin ALEPH 500. Krijimi i një kursi të tillë, të brendshëm profesional, kërkon energji dhe përkrahje. Gjithkund në botën e civilizuar nga eksperimentët ndërtohet funksionaliteti i një institucioni, që, në konvencionalitetin tonë nuk mbizotëron si ide dhe shpeshherë duket e thjeshtë dhe qesharake.

Gjithnjë, në bazë të zhvillimit të veprimtarisë së sotme bibliotekare, mund të bëhet shumë me krijimin e ekipeve atraktive dhe të afta, që do t'i dërgonin përpara proceset krijuese dhe jo vetëm krijuese.

Konkretisht, në të ardhmen, në fushat e zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare brenda BKUK-së dhe jashtë saj, në literaturën tonë bibliotekare mund të trajtohen edhe efektiviteti i hulumtimeve dhe përcaktimi i një matësi profesional për natyrën specifike dhe zhvillimin e bibliotekave publike, universitare, shkollore, speciale, pasurimi i fondeve, përpunimi i materialeve bibliotekare, përshkrimi bibliografik, ose trajtimet e veçanta bibliografike, trajtimi konkret i shpërndarjes së informacioneve në shërbimet e ndryshme bibliotekare, shkrimet për vlerën e ndonjë materiali të rrallë a të vjetër, vizionet e bashkëpunimit të BKUK-së me bibliotekat e vendeve të tjera, funksionaliteti i ardhshëm i ALEPH 500, çështjet e librit elektronik, e shumë çështje të tjera, që do të përbënin një strumbullar të një veprimtarie të rëndësishme të një institucioni të rëndësishëm të këtij vendi.

BKUK-ja, tashmë, ka bërë një hap të mirë, sepse është duke u përgatitur për të hyrë në fazën e rëndësishme të zbatimit të një programi teknologjik, i cili shënon veprimtarinë bibliotekare të këtij shekulli në Evropë dhe gjetiu. Ky kalim nga komunikimi konvencional në atë digjital do të realizohet me zbatimin efikas të programit softwerik ALEPH 500.

Por, a do të thotë kjo se do të zgjidhen edhe problemet e trajtimit teorik, hulumtues e studiues të çështjeve të ndryshme bibliotekare lidhur me programin dhe shërbimet e ardhshme në BKUK? Assesi jo.



# Në kërkim të periodikut të vjetër

## (1848-1912) (II)



GJON BERISHA

Në vitin 1897 doli edhe revista "**Ditërrëfenjësi (*Kalendari*) Shqip**" e shtypur nga shoqëria "Dëshira"e Sofjes, nën drejtimin e Kr. P. Stefan Laurasit. Nga viti 1898 titullohet "**Ditërrëfenjësi (Kalendari) Kombiar**", kurse nga viti 1901 e deri në fund "**Kalendari Kombiar**". Kjo revistë u botua rregullisht vit për vit gjer më 1915. Ky kalendar shpërndahej rregullisht si në atdhe ashtu edhe në të gjitha kolonitë. Kalendari zuri të




botohet me alfabetin latin, me germa të cilat i kishte sjellë nga Bukureshti Kristo Luarasi, në shtëpinë e të cilit ishte vendosur shtypshkronja. Në të bashkëpunuan një numër i madh pendësh të talentuar nga lëmi të ndryshme dhe patriotë të spikatur, siç ishin: Aleksandër Drenova, Jani Vruho, Mihail Xoxe, Loni Logori, Agustino Vebeko, Gjuzepe Skiro, si dhe albanologë të njohur, si H. Pedersen etj.

Viti 1898, në fushën e botimeve periodike ishte shumë i frytshëm. Në këtë kohë me iniciativën e Komitetit Politik Shqiptar të Napolit, filloi të dalë revista "**La Nuova Albania**" – "*Shcipenia e re*", e cila ishte një revistë politike, shoqërore, kulturore, letrare, folkloriste etj. Doli dy herë në muaj në gjuhën italiane dhe pjesërisht shqip, prej 8 faqesh. Numri i parë i saj doli më 1 maj të vitit 1898 nën drejtimin e Avv. Gennaro Lusit dhe nën redaktimin e Gerardo Confortit.

Po këtë vit, filloi të botohej në Bukuresht gazeta e përmuajshme politike, shoqërore, letrare, kulturore me emrin "**L'Etoile Albanaise**" - "*Yll'i Shkjiperisë*", organ i interesave shqiptare. Kjo revistë u shtyp në gjuhët: shqip me alfabetin latin dhe atë të Stambollit, greqisht e frëngjisht, prej 4 faqesh. Numri i parë i saj doli në nëntor 1898 nën drejtimin e avokatit Dhimitër K. Ilio dhe Gjergj Meksit. Mirëpo gazeta "Yll'i Shkjiperisë" si dhe disa të tjera nuk u botuan rregullisht.

Në vitin 1898, po në Bukuresht, nën drejtimin e Dervish Himës, filloi të botohet revista "**L'Independance Albanaise**" – "*Pavarësia Shqiptare*". Një vit më pas, më 1899, përsëri nga arbëreshët e Italisë, filloi punën gazeta "**Echo D'Albania**" – "*Zeni'i Shqipenise*", nën drejtimin e kryeredaktorit Mehmet bej Frashërit dhe redaktorit Dervish Hima (pseudo. I Ibrahim Naxhiut). Kjo ishte një gazetë politike dhe shoqërore, e cila dilte dy herë në muaj në gjuhën shqipe me alfabet të Stambollit dhe frëngjisht, prej 2 faqesh.

Në Bruksel, Faik Konica (me pseudonim Trhank Spirobeg) filloi nxjerrjen e një gazete, e cila filloi të dalë dy herë në muaj në gjuhën shqipe dhe pjesërisht edhe në frëngjisht dhe titullohej me emrin "**Albania e Vogël**". Numri i parë i kësaj gazete doli më 1 nëntor 1899 në fillim në Bruksel, kurse nga nr. 38, gusht 1902, filloi të botohej në Londër. Kjo gazetë u shpërnda pa pagesë në tërë Shqipërinë.

Një kontribut të rëndësishëm në fushën e publicistikës dhe botimeve kombëtare dhanë edhe atdhetarët e Misirit, sidomos u dalluan në përpjekjet për krijimin e një alfabeti të përbashkët për gjuhën shqipe, për mbrojtjen dhe përhapjen e tij gjatë viteve 1908-1910, kur lufta për gjuhën dhe shkollën shqipe u ngrit në një shkallë më të lartë. Organet e shtypit të atjeshëm ishin: gazeta "**Bashkimi'i Shqiptarevet**", gazetë gjysmë shqip e

gjysmë turqisht, e cila filloi të botohej në Egjipt në vitin 1900, me drejtor Ismajl Haki Beun, pastaj me radhë vjen gazeta "**Shqipëria**" (Kajro, 1900-1907), revista "**Toska**" (Misir, 1901-1902), revista "**Besa**" (Caire, 1904-1905), gazeta "**Pellazgu**" (1907), gazeta "**Shkopi**" (Kajro, 1907-1908), gazeta "**Rrufeja**" (Tubhar-Fajun, 1908-1909), gazeta "**Spata**" (Egjipt, 1910-1911), të cilat përbëjnë një thesar të vyer për historinë e shtypit shqiptar të Rilindjes.

Faik Konica, në vitin 1900, filloi të botojë në Bruksel edhe një revistë, e cila u botua vetëm një herë në vit me emrin "**Kalendari i Maleve**". Kjo revistë përmbante kalendarin e festave fetare, materiale nga kultura, kronika, këshilla bujqësore, etj., dhe shtypej në gjuhën shqipe.

Themelimi i shtypshkronjës "Mbrothësia", nën kujdesin e Shoqërisë "Dëshira", bëri të mundur edhe daljen e gazetës së parë në gjuhën shqipe në Bullgari – "**Drita**". Numri i parë doli më 14 nëntor 1901 nën drejtimin e Shahin Kolonjës dhe me zëvendësin përgjegjës Kristo Luarasin. Kjo gazetë ishte e përdyjavshme dhe botohej në 4 faqe me një tirazh prej 670 ekzemplarësh, me alfabetin e Stambollit. "Drita", si gazetë standarde e kohës, krijoi një numër të konsideruar lexuesish dhe korrespodentë, si në atdhe ashtu edhe në koloni. Ajo botonte lajme e letra të ndryshme që flisnin mbi gjendjen ekonomike e shoqërore në Shqipëri nën zgjedhën otomane në dekadën e parë të shek. XX.

Nën drejtimin e veprimtarit Jashar Erabera, në Beograd, filloi të botohej "**Albanija**" një gazetë , e cila dilte 3 herë në muaj në gjuhën shqipe dhe serbisht, frëngjisht, rumanisht, italisht, prej katër faqesh. Numri i parë i saj doli më 28 qershor 1902 dhe vazhdoi jetën e saj deri në vitin 1906. Në kuadër të programit të Shoqërisë "Dëshira", më 21 mars 1903, në Sofje, doli numri i parë i gazetës patriotike "**Vetëtima**". Kjo gazetë, siç shkruante në nëntitullin e saj, ishte organ i kombit shqiptar dhe drejtohej nga Nikolla Naço dhe Thoma Abrami. Gazeta botohej si e përdyjavshme në gjuhën shqipe dhe frënge. Por, kjo gazetë pati jetë të shkurtër. Supozohet se janë botuar 2-3 numra.

Pasi u ndërpre dalja e gazetës "Vetëtima" në Sofje, Thoma Abrami, drejtori i saj, si duket kaloi prapë në Rumani, në Bukuresht, ku ishte shkolluar. Këtë tani e gjejmë në detyrë të drejtorit të një gazete të re me titull "**La Renaissance Albanaise**" - "*Përlindja Shqiptare*". Gazeta dilte në gjuhën shqipe dhe frënge. Edhe kjo gazetë ishte jetëshkurtër, u botuan, me sa dihet vetëm 4 numra. Numri i parë doli më 15 maj 1903, kurse i fundit më 4 korrik të të njëjtit vit. Kjo gazetë doli në një kohë të vrullshme kur, sidomos në vilajetin e Kosovës, zhvilloheshin kryengritjet e njëpasnjëshme.

Në Romë, në vitin 1903 filloi të botohet "**Gazzeta Albanese**" - "*Gazeta Shqiptare*", organ i interesave të shqiptarëve. Kjo gazetë botohej në gjuhën italiane prej 8 faqesh dhe nuk dihet saktësisht se kur përfundoi së dali. Në vazhdën e botimeve nga shqiptarët e Italisë, gjatë viteve 1904-1905 dolën edhe të përkohshmet: "**Il Bruno**" (Bari, 1904-1905), "**La Bandiera Albanese**" – "*Flamuri i Shqiperis*", numri i parë i së cilës doli në Napoli më 1 janar 1904, "**Pro Albania**", revistë e ilustruar letrare në gjuhën italiane me një përkthim në shqip, prej 8 faqesh dhe doli vetëm një numër (*numero uniko*), "**Laimtari i Shqypenis**" (Romë, 1904-1905), revistë politike, shoqërore, kulturore etj., në gjuhën shqipe dhe italiane, prej 8 faqesh. Numri i parë i saj doli më 15 shtator 1904.

Sipas G. Petrotta, *Lingua e letteratura albanese Palermo 1931,* në Shkodër, nga shoqëria "Bashkimi", në vitin 1904, filloi të botet Vjetari i kësaj shoqëria me emrin "**Shqyptari**", e cila i botoi për disa vjet lajmet dhe ngjarjet e vitit.

Në vitin 1905 filloi të dalë një e përkohshme politike, shoqërore e letrare në gjuhën shqipe, italiane, e kroate me emrin "**Shpnesa e Shcypeniis**". Gazeta dubrovnikase për herë të parë doli më 10 nëntor 1905 në Raguzë nën drejtimin e Nikollë Ivanajt. Kjo gazetë u botua në qytetin e Raguzës deri në numrin e 11( 24 dhjetor 1907), kurse, nga numri 12 (24 gush 1907) e deri në numri 17 (24 dhjetor 1907) u botua në Trieshtë. Nga numri 1 (1 korrik 1908) e deri në fund u botua në Romë dhe dilte dy herë në muaj.


Kombi

Më 15 qershor 1906, Sotir Peci dhe Fan Noli filluan botimin e një gazete të përjavshme në gjuhën shqipe dhe pjesërisht në frëngjisht, italisht dhe anglisht - me emrin "**Kombi**". Nga nëntitulli i saj mësojmë se ishte një gazetë politike, shoqërore, kulturore e letrare prej 6-faqesh.

**/vijon në numrin e ardhshëm/**

# BKUK po hyn në rrjetin ndërkombëtar të informacionit bibliotekar

/ vijon nga faqja 1 /

Të gjitha këto trajnime, të udhëhequra nga ekspertë të kompanisë Ex Libris, nga Dominic Nast – menaxher i projektit për BKUK, dhe Michael Ben Ami – trajnues për përdorimin e moduleve të programit Aleph 500, kanë vijuar edhe pas këtyre fazave të trajnimit nga stafi i BKUK-së. Këto trajnime vijuese kanë rritur edhe më shkallën e besueshmërisë ndaj programit Aleph 500, si dhe kanë nxjerrë në pah nevojën për trajnime në vijueshmëri në këtë program.

Një prej trajnimeve, që pritet të zhvillohet, është edhe trajnimi në Modulin e Qarkullimit, i cili përbën një aspekt shumë të rëndësishëm të programit si tërësi, dhe që është në lidhje të drejtpërdrejtë me menaxhimin dhe plotësimin e kërkesave të përdoruesve të BKUK-së.

Me përfundimin e trajnimit në Modulin e Qarkullimit, përmbyllet faza e trajnimeve nga ana e kompanisë Ex Libris. Ky trajnimi do të vazhdojë me trajnime shtesë edhe për një kohë të caktuar, për ta përvetësuar sa më mirë këtë program. Kah fundi i këtij viti, BKUK do të fillojë fazën e parë për krijimin e bazës së të dhënave bibliografike – që nënkupton ofrimin e shërbimeve elektronike për përdoruesit. Kjo shënon ndryshimin më të madh që do të ndodhë në bibliotekarinë kosovare.

Mundësitë e shtrirjes së programit Aleph 500 në bibliotekat ndërkomunale

Me qëllim të shtrirjes së programit Aleph 500 dhe të krijimit të një rrjeti bibliotekarë në tërë Kosovën, BKUK dhe Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës, kanë organizuar një sesion informues dyditorë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bibliotekave ndërkomunale. Qëllimi i këtij sesioni ka qenë informimi i pjesëmarrësve me programin ALEPH 500 dhe me planet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës për shtrirjen e këtij sistemi në mbarë bibliotekat e Kosovës.

Sesioni është përqendruar në informimin me shërbimet që ofron ky program, rrugët të cilën e ka ndjekur BKUK-ja për të arritur deri te programi, përgatitjet teknike, trajnimet e stafit të BKUK-së etj. Përfaqësuesit e bibliotekave ndërkomunale, gjithashtu, janë informuar për përparësitë dhe rëndësinë që do të ketë bibliotekaria kosovare kur do të të implementohet i njëjti program në gjithë territorin e Kosovës, si: harmonizimi i të dhënave bibliografike, standardizimi i rregullave të punës, krijimi i një rrjeti të shpejtë dhe të harmonizuar bibliotekarë, zhvillimi i njëjtë i të gjitha bibliotekave, shpenzimet e ulta në pajisjen e rrjetit dhe mirëmbajtjen e tij, si dhe një mori faktorësh të tjerë.

Gjithashtu, pjesëmarrësit janë informuar me mundësitë që ofron moduli i katalogimit; me formatin MARC21; mundësitë e përdorimit të një të dhëne bibliografike nga të gjitha bibliotekat; përdorimin e rregullave të reja të katalogimit – AACR2; ndryshimet mes katalogut në letër dhe katalogut elektronik; me kërkimet në katalogun në internet; me krijimin e katalogut përmbledhës të Kosovës etj.

Pra, të gjitha këto projekte, iniciativa e veprime kanë për synim përgatitjen dhe mobilizimin e gjithë kuadrit të brendshëm bibliotekar të BKUK-së, si dhe atij të jashtëm – të bibliotekave ndërkomunale, për hyrjen në zhvillimet e reja dhe moderne të sistemit bibliotekarë dhe krijimin e një rrjeti unik, që do ta bënte Kosovën njërën prej hallkave - pjesë të rrjetit ndërkombëtar të informacionit bibliotekar.

**Përgatiti: Besim J. Kokollari**

# Huazimi ndërbibliotekar

DR. BAHTIE GËRBESHI

Zhvillimi i teknologjisë ka rezultuar me përparimin e punës në biblioteka në të gjitha segmentet, e posaçërisht në fushën e huazimit ndërbibliotekar. Çdo kërkesë për huazimin e librit ose të artikullit dhe realizimi i tyre është më i shpejtë dhe më kualitativ. Për përdoruesin, që kërkon informatë të saktë dhe të shpejtë, biblioteka është qendër, e cila mund t'u përgjigjet plotësisht këtyre kërkesave.

Duke u nisur nga fakti që biblioteka nuk është në gjendje që përdoruesit të saj t'i ofrojë të gjitha informatat e mundshme nga fondi i vetë, paraqitet nevoja për bashkëpunim me bibliotekat e tjera, me qëllim që të plotësohen nevojat e përdoruesve. Praktika e shkëmbimit të materialeve ndërmjet bibliotekave përbën një aktivitet të rëndësishëm dhe është pjesë e pandarë e politikës së pasurimit të fondeve bibliotekare.

Bibliotekat kanë obligim t'u ofrojnë informata përdoruesve të tyre, por edhe të mbështeten në institucionet e tjera, të njëjta, me qëllim të plotësimit të atyre kërkesave.

Kështu që, huazimi ndërbibliotekar është një nga funksionet vitale të bibliotekës. "Interlibrary Loan" (shkurtimisht ILL), "Document Delivery Service", *(Huazimi ndërbibliotekar)* janë terma, me të cilët e quajmë procesin, me të cilin bibliotekari kërkon ose i jep materiale bibliotekës tjetër, me qëllim të plotësimit të kërkesave të përdoruesve, për të marrë informacione, që gjithsesi duhet t'i ofrojë biblioteka. Kështu, biblioteka që huazon material bibliotekar përcakton kriterin se cilat materiale mund të huazohen e cilat jo. Ajo duhet të ketë rregullore edhe për pagesën e materialeve që huazon.

Biblioteka ngarkohet me shpenzime shtesë vetëm nëse materiali i dërguar kërkon paketim të veçantë. Shpenzimet e dërgimit i ngarkohen përdoruesit të materialit, kur është fjala për dërgim të shpejtë të tij, dhe në këtë rast, përdoruesi i materialit të huazuar ka detyrime të reja.

Huazimi ndërbibliotekar zhvillohet:
- në vend dhe
- me botën e jashtme.

Hapi i parë është intervista me përdoruesin, për të pasur një pasqyrë të qartë, çka ai saktësisht kërkon, në mënyrë që të merren referenca të sakta. Para dërgimit të kërkesës, citati vërtetohet në burimet relevante, me qëllim të vërtetimit të saktësisë.

Hapi tjetër është që të hulumtohet biblioteka që e ka materialin, njëherë në vend, e pastaj edhe jashtë vendit. Nëse një bibliotekë e jashtme e ka materialin që e kërkojmë, qoftë ai libër ose artikull, të vërtetohet se a ka qendër ILL, dhe ta informojmë përdoruesin se sa mund të zgjasë procedura.

Shumica e vendeve kanë bibliotekë qendrore që është e obliguar për këtë lloj bashkëpunimi.

Mënyrat e dërgimit të kërkesës janë:
- Standarde: forma IFLA, Fax
- Elektronike: e-mail (forma on- line)

Dërgimi mund të bëhet me:
- Postë (nëse materiali është libër)
- Fax dhe e-mail (kur kemi të bëjmë me artikuj nga revistat)
- Revistat elektronike dhe On - Line baza e të dhënave (qasje me anë të Internetit)

Në shpejtësinë dhe kualitetin e kërkesave për informacione ka ndikim të madh zhvillimi i teknologjisë informative. Zotërimi i njohurive të punës në kompjuter dhe qasja në Internet janë me rëndësi të jashtëzakonshme për kryerjen e këtyre punëve, në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më efikase.

Interneti dhe kompjuteri ua bëjnë të mundur përdoruesve, që shumë shpejtë t'i gjejnë informacionet e duhura, që d.m.th. të ulur pranë kompjuterit të tyre, kudo qofshin ata, të kenë qasje në informata nga vende të ndryshme të botës, pa marrë parasysh që atë informatë e ka edhe ndonjë bibliotekë tjetër.

Në praktikën tradicionale, bibliotekari me anë të postës ka dërguar kërkesën, duke e pasur të qartë se për këtë kërkesë biblioteka është dashur të presë me javë të tëra për t'i marrë materialet.

Sot, bibliotekari e gjen website-n e bibliotekës për të cilën mendon se mund ta ketë librin a revistën e dëshiruar, hyn në katalogun on-line të asaj biblioteke, kërkon dhe e gjen përgjigjen. I merr të dhënat nga ai katalog, sidomos signaturën dhe informohet se a është ai libër i lirë, a është dhënë në shfrytëzim apo gjendet jashtë bibliotekës.

Kërkesa udhëzon për mënyrën, që është më e pranueshme në kushtet e dhëna dhe e cila varet nga lloji i literaturës, mundësitë e bibliotekës të cilës i dërgohet kërkesa, etj.

Mënyra më e shpejtë është dërgimi me Fax, dhe dërgimi elektonik i dokumenteve (EDD-Electronic Document Delivery), dy mënyra të komunikimit të mjaftueshme për një bibliotekë, sepse e shfrytëzojnë dhe e thjeshtësojnë transmisionin e të dhënave. Nëse bëhet me e-mail, atëherë kohëzgjatja është minimale, që është me interes të jashtëzakonshëm për përdoruesin. Nëse biblioteka nuk e ka materialin që i kërkohet, kërkesa automatikisht shkon tutje deri te përgjigjja pozitive, e cila i drejtohet bibliotekës- dërguesit.

Kështu, në këtë segment të bibliotekarisë, teknologjia bashkëkohore kompjuterike ka rëndësi tepër të madhe, sepse shpejton dhe përmirëson komunikimin dhe kualitetin e informacioneve, qëllimi i fundit i të cilave është - përdoruesi. Tash, në mileniumin e elektronikës dhe të kompjuterëve, ky segment i bibliotekarisë ka marrë domethënien e tij të plotë dhe të përsosur.

# Qasje të kufizuara në përdorimin e materialeve muzikore në BKUK



EDONA MUNISHI

Përkundër të arriturave të mëdha teknologjike në qasje në informacione, biblioteka ende mbetet e pazëvendësueshme në grumbullimin dhe në shpërndarjen e dijes. Risitë teknologjike ia lehtësuan punën bibliotekës, ia ndërruan fizionominë. Ajo, tashmë, është ngritur në një institucion kulturor shumëfunksional. Në një vend, ku koncentrohet mendja dhe të arriturat e njeriut, në një vend të shenjtë, ku merret dija dhe absorbohet ajo, shërbimet e këtij institucioni janë të mëdha dhe të paskajshme; përveçqë ka karakter të grumbullimit (koleksionimit), të ruajtjes së lëndës, ka edhe karakter të shërbimit, që nënkupton shfrytëzimin e pasurisë, që gjendet në të.

Në kuadër të tërësisë së lëndës bibliotekare bën pjesë edhe muzika, si ajo e shkruar ashtu edhe ajo fonike, e zëshme. Në mjedisin tonë kulturor, në Kosovë, sikur ende nuk është arritur një shkallë e kënaqshme e një relacioni të ndërsjellë ndërmjet shfrytëzuesit muzikor dhe institucionit të bibliotekës. Ndodh kështu, si pasojë e disa rrethanave, jo të favorshme, për krijimin e një ndërlidhjeje të kërkuar. Me qëllim të një sensibilizimi, sado të vogël, të kompetentëve të bibliotekave, në njërën anë, dhe të interesuarve, për shfrytëzimin e lëndës muzikore, në anën tjetër, shtrojmë një temë, që të dyja këto palë, për mjedisin tonë, t'i afrojmë në një komunikim të afërt eventual. Prandaj, kësaj radhe, përqendrohemi në mundësitë e ofruara, në mjedisin tonë kulturor, dhe të shfrytëzuesit potencial, të fondeve dhe materialeve muzikore.

## PËRDORUESIT DHE QASJA NË MATERIALET MUZIKORE

Për dallim nga fondet e tjera bibliotekare, që mund të shfrytëzohen vetëm në formë konsultimi e leximi, muzika, përveç të tjerash, të interesuarit i servohet edhe në formën audio e video kontaktit. Pra, e shikuar dhe e dëgjuar. Nga kjo specifikë dalin edhe kërkesat e plotësimit të disa kushteve, pak më të veçanta, për t'ia ofruar të interesuarit mudësitë objektive. Në kohën tonë, moderne, kur mendohet se interesimit për librin ka rënë dukshëm, si pasojë e zhvillimit të teknikës së komunikimit masiv, ka një skepticizëm edhe për shfrytëzimin e muzikës në institucionet e bibliotekarisë. Për grumbullimin e fondeve dhe të materialeve muzikore, si lëmi specifike, paraqiten edhe disa vështirësi. Nga kjo specifikë përcaktohet edhe numri i shfrytëzuesve të muzikalieve e që në krahasim me fushat e tjera nuk është edhe aq i madh. Përkundër këtij fakti, duhet menduar se gjenden të interesuar, kurse bilbioteka si institucion publik, në mënyrë permanente duhet ta ketë parasysh rëndësinë socio-kulturore, që ka, pasurimi i saj me materiale e lëndë edhe nga fusha e artit dhe e kulturës muzikore. Të interesuar për materiale muzikore ka pasur dhe do të ketë gjithmonë. Këtu i veçojmë disa kategori shfrytëzuesish: muzikëdashësit a adhuruesit e muzikës; muzikofilët, të cilët mund ta kenë ose jo muzikën profesion, por që e admirojnë; dhe profesionistët që i shfrytëzojnë hapësirat e bibliotekës. Në nivelet e arsimimit shkollor profesional të muzikës, ose në shkolla të tjera, punohen tema diplomash, për të cilat duhet konsultuar e shfrytëzuar literaturë dhe materialet e tjera muzikore. Janë nxënësit e studentët e arsimimit profesional muzikor, të cilët në bibliotekë provojnë ta gjejnë atë që u sugjerojnë mësimdhënësit e tyre. Dhe, natyrisht, kategoria tjetër janë studiuesit e fushave e disiplinave të ndryshme të muzikës dhe profesionistët e një niveli më të lartë që kërkojnë mundësinë e qasjes së tyre në pasurinë muzikore që ka biblioteka. Në vazhdim, shkurtazi provojmë t'i shkoqisim kërkesat më

elementare të këtyre kategorive të të interesuarve, për shfrytëzimin e fondeve muzikore në bibliotekë.

## NGA PASIONANTËVE E DERI TE STUDIUESVE TË MUZIKËS – QFARË U OFROHET?!

Nga kjo kohë dhe nga një distancë e caktuar kohore, shikimi i shumë gjërave duket të jetë nostalgjik. Por, megjithatë, kohërat i lidh një vijë konstante, që vështirë bëhet e pashkëputshme. Interesimi dhe dashuria për muzikën nuk është as vetëm i një kohe të shkuar, po edhe

as vetëm i kësaj kohe. Muzika, gjithmonë e gjithherë në vazhdim do të mbetet arti më komunikues e më i përafërt i njeriut. Nga literatura, karakteresh të ndryshme, mësohet se gjithnjë ka pasur muzikëdashës apasionantë, të cilët në forma të ndryshme e kanë shfrytëzuar përjetimin muzikor, të muzikës së pëlqyer. Edhe në mjediset ku ka pasur salla të koncertit, por më theksueshëm në ato mjedise ku kanë munguar ato, aderuesi i muzikës ose ka qenë koleksionues i materialeve muzikore të incizuara ose ka shfrytëzuar institucionet, ku ka pasur fonde muzikore siç janë: arkivat, muzetë, mediat elektronike dhe natyrisht edhe bibliotekat. Deri para pak dekadash (dy-tri dekada), kur mjetet elektronike nuk kishin një shtrirje të madhe në shoqëri, biblioteka konsiderohej vendi më i përshtatshëm për të dëgjuar muzikën e dëshiruar. Kjo vlen për mjediset me nivel të lartë kulturor dhe me emancipim të ngritur muzikor. Bibliotekat ishin të pasura me incizime veprash të literaturës botërore, dhe i interesuari kërkonte të gjente vendin e lirë në hapësirën e caktuar me magnetofon dhe lëshonte diskun me veprën e kërkuar, dhe me dëgjuese në vesh, dëgjonte dhe e përjetonte me kënaqësi të madhe muzikën e preferuar. Kjo vazhdon të ndodhë ende, në ato mjedise të asaj shkalle kulture, ku institucioni i bibliotekës është ngritur në kult, por kjo nuk ndodh ende te ne.

Në disa qytete tona, këtu në Kosovë, ka dhjetëra vite, që janë hapur shkollat e ulta (fillore) e të mesme të muzikës, janë bërë tri dekada që në kuadër të Fakultetit të Arteve është edhe Dega e Artit Muzikor, me shumë drejtime. Nga këto nivele të arsimimit muzikor vijojnë dhe dalin një numër i madh muzikantësh, të cilët në kushte e rrethana të farovshme, gjithnjë do të ishin shfrytëzuesit më potencialë të lëndës muzikore që gjendet në bibliotekë. Ky komunitet kulturor, gjithnjë, synon dhe pretendon për ngritje sa më të madhe profesionale muzikore dhe do të arrihet më me lehtësi dhe më me sukses kur mundësitë e qasjes në literaturë të bëhen më të favorshme dhe kur fondi muzikor në bibliotekë të jetë sa më i pasur. Duhet kuptuar se mjedisi ynë me traditë të shkurtër të artit dhe të kulturës muzikore ka mungesë të shumëçkajes për t'i plotësuar interesimet e profesionistëve të muzikës. Janë përpjekje të mundimshme të muzikantit, të profileve të ndryshme, që të gjejë literaturën muzikore interpretuese. Po deshi flautisti, violinisti, klarinetisti, solo këngëtari, e cilido instrumentist e interpret tjetër, të kërkojë literaturë muzikore për të marrë në programin e tij, të gati çfarëdo niveli, e ka të vështirë të vijë deri te partitura e ndonjë vepre, të cilën mund ta ketë dëgjuar nga ndonjë koleg i tij nga ndonjë mjedis tjetër kulturor. Sigurimi i veprave muzikore bëhet ose përmes mësimdhënësit, nëse ai i ka, ose në forma të tjera nga vetë instrumentisti. Shikuar objektivisht për secilin mjedis, me pretendime kulturore, kjo nuk do të duhej të bëhej çështje problemore, sepse literaturë notale muzikore do të gjendej në gati secilën bibliotekë, e të mos flasim për ato biblioteka të specializuara muzikore, ose për ato me

karakter kombëtar. Fatkeqësisht, fondet muzikore në bibliotekat tona janë shumë të varfëra, qoftë në ato mini-biblioteka, që dikur ishin nëpër shkollat e muzikës, në fakultet (që tashmë nuk funksionojnë), por edhe në BKUK. Dirigjenti që dëshiron të përgatisë çfarëdo vepre muzikore vokale, e vokaloinstrumentale, duhet të gjendet vetë, sepse në bibliotekën tonë nuk gjendet gati asnjë partiturë e veprave muzikore, me përjashtim të donjë kompozitori shqiptar, të kësaj kohe.

Andaj, nuk është e rastësishme mungesa e punimeve të diplomës në fakultet ose e ndonjë punimi të magjistraturës a doktoratës. Është hendikep i madh mungesa e literaturës muzikore. Kjo, për faktin se mungojnë incizimet, partiturat e edhe literatura e shkruar mbi muzikën. Studiuesi e ka të vështirë të trajtojë e të studiojë cilëndo periudhë të historisë së muzikës, qoftë të asaj botërore a të asaj nacionale, veprimtarinë e cilitdo kompozitor, në mungesë të literaturës së nevojshme dhe të domosdoshme.

## PASURIMI E TRAJTIMI I KOLEKSIONEVE TË MUZIKALEVE

Tani mund të gëzojë fakti dhe të jetë shpresëdhënës, për të gjithë të interesuarit, se në kuadër të Koleksioneve të Veçanta është funksionalizuar edhe një nënsektor i muzikologjisë, që dëshmon një interesim të kompetentëve, që edhe kjo fushë e artit të gjejë funksionalizimin e saj në këtë institucion. Këtu, viteve të fundit, nuk mungon përkrahja, mbështetja për ta organizuar sa më mirë e sa më kënaqshëm, pjesën që i takon lëmisë së muzikës, por si duket mungojnë mjetet materiale për pasurimin më të madh të fondeve muzikore për t'i plotësuar të gjitha nevojat dhe kërkesat e të interesuarve për muzikën, në këtë hapësirë kulturore. Me vetë pasurimin e këtyre fondeve do të shtoheshin të interesuarit, do të afirmohej edhe biblioteka, e në veçanti edhe vetë sektori i përmendur. Dhe, atëherë, ai drejtim do të funksionalizohej dhe do të bëhej i përdorshëm e jo vetëm arkivor dhe i konservuar, sa për të thënë se është i hapur. Çka duhet të bëjë biblioteka për t'i siguruar dhe për t'i plotësuar nevojat e të interesuarve për shfrytëzimin e fondeve muzikore, mund të jetë njëra nga tema që mund të shtrohet në ndonjë shkrim tjetër në vazhdim. Ajo, që është parësore për BKUK-në mbetet vazhdimi i interesimit që lëmia e muzikës, në këtë institucion, të jetë e përfaqësuar sikurse në bibliotekat e këtij karakteri në mjediset e tjera kulturore, që lë të kuptohet se duhet përpjekur, vazhdimisht, të sigurohen mjete materiale për pasurimin sa më të madh të të gjitha fondeve muzikore.




Përkundër vullnetit dhe interesimit të përgjegjësve të bibliotekës, megjithatë, kompetentët që kanë mundësi e vullnet ose që e kanë për detyrë për ta ndihmuar bibliotekën tonë, është mirë të mendojnë me një vetëdijësim më të fuqishëm, sepse edhe prania e muzikës në bibliotekë paraqet një vlerë të madhe kulturore. Prandaj, kërkohet mbështetje e vazhdueshme e të gjithëve, që të krijohen kushte dhe mundësi, sa më optimale, për grumbullimin dhe shfrytëzimin e fondeve dhe të materialeve që janë në interes të shumë shtresave, si dhe të vetë kulturës, të artit dhe të shkencës muzikore, në përgjithësi.

# Zgjedhja e materialeve bibliotekare

## *Dilemat me rastin e zgjedhjes - nevojat dhe dëshirat*

Për bibliotekarët, zgjedhja e burimeve është njëra nga punët më të ndjeshme profesionale, me rëndësi të njëjtë me katalogimin a shërbimin për dhënien e informatave.

Zgjedhja e materialeve, për një kohë të gjatë, ka qenë objekt i diskutimeve profesionale dhe vazhdon të jetë aktuale edhe tash.

Edvard Evans, në botimin e tretë të librit "Developing library and information center collections", si dhe në http: / lib.lmu.edu/ dlc4, jep një pasqyrë të plotë të asaj që e quan "teori" të zgjedhjes, të bazuar në 11 librat më kryesorë të botuar prej vitit 1925 deri më 1985. Principet e paraqitura në këtë analizë të thellë mund të përfshihen në gjithsej disa fjalë: nevojat karshi dëshirave, ose kualiteti karshi kërkesave.

Nga ky dualitet fillojnë principet kyçe me të cilat fillon zgjedhja e përshtatshme dhe e dobishme.

Principi i parë është që lexuesi (përdoruesi) të jetë në qendër të vëmendjes të çdo seleksionimi, të pasurimit të fondeve dhe të shërbimeve informative.

Derisa një informator (bibliotekar) ekspert mund ta kundërshtojë qëndrimin për zgjedhjen e materialeve bibliotekare, me qëllim që përdoruesve t'u ofrojmë pikërisht atë që ata e dëshirojnë, tjetri informator (bibliotekar) do ta përmirësojë këtë qëndrim, duke shprehur bindje të thellë se duhet zgjedhur materialin më të mirë të mundshëm, i cili do t'i plotësonte kërkesat e përdoruesve. Bibliotekari i tretë mund të shkojë edhe më larg, duke shprehur bindjen që biblioteka, thjesht, duhet të zgjedhë çdo gjë ekzistuese që është më e mira, pa marrë parasysh se çka kërkohet nga përdoruesit.

Konstatimi që bibliotekat dhe qendrat informative ekzistojnë për t`u shërbyer klientëve të tyre dhe që zgjedhja bazohet në principin e plotësimit të nevojave dhe dëshirave të përdoruesve, është përafërsisht i thjeshtë dhe i qartë, por nga ky princip i drejtë rrjedhin disa pyetje të vështira:

- Cilat janë saktësisht kërkesat dhe dëshirat?
- Kush duhet t`i artikulojë ato?
- Ku qëndron baraspesha ndërmjet plotësimit të nevojave dhe dëshirave?

Për një kohë të gjatë është diskutuar rreth çështjes se a duhet biblioteka të sigurojë qasje në ato materiale, që klientët pohojnë se i "dëshirojnë", apo në ato materiale, që ata mendojnë se iu "nevojiten".

Rezyme të qartë mbi diskutimin "dëshira kundruall nevojave" ka dhënë, para disa vitesh, Robert Broadus në botimin e dytë të librit "Selecting materials for libraries", i cili të gjitha rastet, kur klientët përcaktojnë saktësisht atë që kërkojnë, i ka përfshirë në pesë argumente kryesore:

- Bibliotakari nuk ka të drejtë t'ua imponojë bindjet personale përdoruesve;
- Njerëzve duhet t'u plotësohen nevojat me atë që do ta shfrytëzojnë, e jo me materiale që, duke mos u lexuar, do të mbledhin pluhur nëpër rafte;
- Grumbullimi i asaj që njerëzit kërkojnë nuk do të thotë që rezultati, automatikisht, të jetë vetëm në një nivel të kualitetit, sepse në mesin e përdoruesve ekziston ndryshueshmëri e mjaftueshme, kurse dëshirat e tyre do të rezultojnë me një spektër të gjerë kualitetesh;
- Nëse përdoruesit e ndihmojnë bibliotekën financiarisht, ata kanë të drejtë që të përcaktojnë se çka do të hyjë në fondin e saj;
- Nëse njerëzve u ofrojmë atë që "dëshirojnë", ata me siguri edhe do ta lexojnë atë, dhe kjo ndihmon në krijimin e një shprehie të rëndësishme.

Sipas R. Broadus, arsyet për blerjen e asaj që konsiderohet që u "nevojitet" përdoruesve, e jo të asaj që ata kërkojnë, mund të përmblidhen në këtë mënyrë:

- Biblioteka është e obliguar t`u përgjigjet nevojave të përdoruesve, kështu që do të furnizohet me material shumë kualitativ;
- Biblioteka ka obligim që t'i edukojë përdoruesit, kurse këtë e arrin me stimulimin e tyre, që ndikon në të menduar dhe në qëndrime;
- Biblioteka nuk bën gara me qoshqet dhe libraritë, të cilat shumë mirë i plotësojnë nevojat e lexuesve me atë që ata dëshirojnë;
- Biblioteka duhet ta përmirësojë shijen e leximit, dhe këtë e bën duke blerë veprat, të cilat në një mënyrë tjetër nuk do të njiheshin dhe nuk do të vëreheshin nga përdoruesit;
- Pa motive shtesë, shija e lexuesit mesatar është jashtëzakonisht e ulët dhe e disfavorshme për "sa më mirë", në çfarëdo fushe qoftë.

Të dyja pikëpamjet për këtë çështje mbrohen me bindje të njëjta dhe askush ende nuk ka sjellë argumente përfundimtare për cilëndo qoftë prej tyre. Çdo ekspert i bibliotekarisë duhet të vendosë vetë dhe të marrë qëndrim të qartë lidhur me çështjen "nevojat karshi dëshirave"; ai qëndrim në një masë të madhe do ta kushtëzojë zgjedhjen e tij për fond. Qëndrimi fleksibil, i cili provon të përfshijë anët pozitive prej të dy argumentimeve, përafërsisht do të mbështetej në pikat vijuese:

- Biblioteka ekziston për t`u shërbyer përdoruesve të saj dhe për këtë shkak duhet marrë parasysh atë që kërkohet saktësisht;
- Por, nëse bibliotekari zgjedh vetëm atë që përdoruesit kërkojnë, këtyre njerëzve nuk u jepet rasti që t'i përmirësojnë dituritë dhe shijen e tyre;

- Nëse atyre u ofrohet material shumë kualitativ, së bashku me atë që kanë kërkuar saktësisht, ndoshta do të fillojnë ta çmojnë dhe ta shfrytëzojnë edhe materialin që u është ofruar;
- Për ta ndihmuar realizimin e qëllimeve rekreative, informative dhe edukative, biblioteka ka obligime që të blejë materiale për shijen e secilit - të mirë ose të keqe;
- Bibliotekarit, si ekspert për zgjedhje, duhet t'i besohet zgjedhja e materialit shumë kualitativ, i cili është në përputhshmëri me nevojat e përdoruesve, sikurse edhe atë që përdoruesit e kërkojnë saktësisht.

Kjo dilemë, pjesërisht mund të zgjidhet, nëse përkujtojmë qëllimet e ekzistimit të bibliotekave ose të institucioneve, pjesë e së cilës është ajo. Bibliotekat e fakulteteve bëjnë përpjekje që të sigurojnë vetëm materiale kualitative, që janë të kërkuara nga klientët e tyre. Në anën tjetër, një bibliotekë shkollore duhet të sigurojë burime që edukojnë dhe informojnë, dhe të cilat mund të kontribuojnë në edukimin personal të nxënësve. Kjo bibliotekë do të sigurojë material shumë kualitativ, por një arsimtar - bibliotekar i mençur do të sigurojë, gjithashtu, edhe ndonjë vepër të njohur, që t'i inkurajojë edhe lexuesit e pavullnetshëm. Njësoj mund të vërehet edhe në bibliotekat publike, në të cilat është e domosdoshme baraspesha.

Në të vërtetë, zgjidhja e këtij debati qëndron në gjetjen e baraspeshës ndërmjet dy pikëpamjeve, zgjidhje e cila merr parasysh qëllimet e bibliotekës dhe të institucionit, që eventualisht ajo i shërben.

Zgjidhja ideale duhet të jetë:

- në përputhshmëri me programin e përvetësuar për pasurimin e fondit;
- i bazuar në njohjen e bibliotekës, fondit të tanishëm dhe klientëve të saj;
- e mundur, të bazohet në njohuritë lëndore, nëse është arritur formalisht ose me anë të kontakteve të gjata në lëmi të caktuara.



## KËRKESAT KRYESORE PËR ZGJEDHJE TË MIRË

Diskutimet "nevojat karshi dëshirave" mund të vihen nën pesë rregullat e njohura të bibliotekarisë, të cilat i ka paraqitur bibliotekari i njohur indian S. R. Ranganatan (1892-1972) në veprën "Library book selection":

- librat janë për t'u shfrytëzuar;
- secilit lexues - libri i tij;
- secilit libër - lexuesi i tij;
- kursejeni kohën e lexuesit;
- biblioteka është organizëm shpërndarës.

Duke u shërbyer me pesë rregullat e Ranganatanit mund t'i propozojmë disa principe kryesore për zgjedhje. Këto principe, këtu do të paraqiten si pikënisje, prej të cilave secili do të zhvillojë më tutje direktivat personale për zgjedhje të kënaqshme:

- Procesi i zgjedhjes është i lidhur me punët e tjera profesionale dhe varet prej tyre, sikurse për dispozitat programore, gjithashtu edhe për procedurat praktike. Zgjedhja është pjesë e procesit gjithëpërfshirës të menaxhimit të fondit dhe duhet të vështrohet nga ajo perspektivë;
- Secili duhet t'i plotësojë njohuritë profesionale duke përcjellur rregullisht literaturën lidhur me principet dhe praktikën e menaxhimit të fondit, me zgjedhjen, me botimet, me veprat kritike dhe me blerje;
- Secili duhet t'i njohë qëllimet e bibliotekës së tij, fondin e saj dhe kategoritë e përdoruesve. Këta janë përbërësit kryesorë për zgjedhjen e materialit të përshtatshëm bibliotekar;
- Bibliotekari i mirë, i cili e bën zgjedhjen, do të arrijë njohuri të domosdoshme të veprimtarisë botuese dhe mënyrën në të cilën funksionon tregu i librit, njohjen e procesit të krijimit, të distribuimit dhe të shitjes së të gjitha llojeve dhe të formave të materialeve bibliotekare;
- Të gjithë duhet të jenë të njoftuar mirë me programet e botimeve, mediumet për lajmërime, vendet lajmëruese, me emrat e redaktorëve të shtëpive botuese me famë dhe atyre botuesve, produksioni i të cilëve është më i rëndësishmi për nevojat e menaxhimit të fondit bibliotekar;
- Të gjithë duhet të jenë të gatshëm që në çdo moment të paraqesin ide (qëndrime) të argumentuara dhe të pavarura lidhur me zgjedhjen e materialit për bibliotekën e tyre, pa marrë parasysh që ekspertët kompetentë janë në pozitë më të mirë që të zgjedhin materialin e vërtetë për fondin e caktuar dhe atë që do ta shfrytëzojnë.

Përgatiti: Dr. Bahtie Gërbeshi - Zylfiu

# Metodat e restaurimit në BKUK

BLERTA SLISHANI

Letra e fabrikuara (prodhuara), që nga mesi i shek. XIX është e aciduar tepër. Si rrjedhim, letra dëmtohet më shpejt. Prodhimi masiv i letrës (i materialit bibliotekar në letër) e ka reduktuar cilësinë e saj, andaj një pjesë e madhe e botimeve, pas vitit 1850, janë acidike, të brishta dhe shkatërrohen shpejt në krahasim me botimet më të vjetra.

Prandaj, meqenëse shumica e materialit që ndodhet në Bibliotekë është libër (letër), është me rëndësi të dihet edhe mirëmbajtja e saj, punë kjo që e bëjnë Qendrat e Restaurimit dhe Konservimit. Pra, ato, në këtë kontekst, janë përgjegjës për stabilizimin kimik dhe tretmanin fizik në tërësi të materialit, si dhe në veçanti për gjërat e rralla, (të çmuara) – material bibliotekarë – duke përfshirë restaurimin dhe konservimin llojeve të ndryshme të materialit - hartave, atlaseve, dorëshkrimeve, globeve, gjërave të shtypura dhe vizatimeve, postereve, fotografive, gazetave, revistave, etj. Kjo nënkupton përpjekjen për ta rikthyer materialin në gjendjen e vet sa më origjinale - afër gjendjes së origjinalit, duke e mirëmbajtur e arkivuar në gjendje të përdorshme.

Para fillimit të restaurimit të materialit bibliotekar, bëhet mikrofilmimi (fotografimi) i secilës faqe, ose së paku i atyre që janë më tepër të dëmtuara, (zakonisht pas restaurimit nuk përdoret ai material por përdoret mikrofilmi, në mënyrë që të mos dëmtohet). Ndërsa në laboratorët e modernizuar, para restaurimit, përdoret skanimi.

Intervenimet që arrihet të bëhen në Qendrën e Restaurimit dhe të Konservimit të BKUK-së, pas pranimit të materialit libër (letër) të dëmtuar, janë: heqja e pluhurit; dezinfektimi; neutralizimi; (zbardhja ose heqja e njollave me mjete kimike në qoftë se kjo është e domosdoshme); restaurimi me dorë; rrafshimi i fletëve; rregullimi i kopertinave (qoshet, shpina); laminimi.

Me rastin e pranimit të materialit, së pari duhet që të shënohen numrat e fletëve me laps të thjeshtë dhe në vendet e padëmtuara bëhet paginimi. Bëhet heqja e pluhurit në të thatë në komorë speciale për heqjen e pluhurit. Pluhuri hiqet me brushë ose me pambuk; për mbrojtjen e konservatorit para çdo procesi duhet që të vendoset manteli, maska mbrojtëse dhe dorëzat. Pastaj bëhet dezinfektimi i materialit në laboratorin e restaurimit dhe konservimit, zakonisht dezinfektimin e bëjmë me alkool etilik të përzier me timol në një elermajer. Para dezinfektimit shikohet se a është pastruar pluhuri mirë dhe, nëse ka njolla, ato pastrohen me gomë, nëse ka shtresa të trasha, nga dheu, bimët ose shtazët, ato duhet të gërryhen me skalper, pastaj fshihen ngadalë dhe fillon dezinfektimi. Njollat e ndryshme mund të largohen edhe me mjete të ndryshme kimike si: benzinë, etër, kloraminT, aceton, etj., pra këto preparate përdoren varësisht nga prejardhja e njollave.

Merret një copë vatë (pambuk) me pincetë dhe i pastrojmë fletët një nga një me lehtësi nga mesi, duke shkuar skajeve, që të mos dëmtohen; në qoftë se teksti lëshon ngjyrë dezinfektohen vetëm skajet e bardha. Fletët duhet të pastrohen në të dy anët.

Neutralizimi d.m.th: letra me pH neutrale është më e ruajtur se ajo acidike. Kimikisht, qëndrueshmëria (kohëzgjatja e jetës) e letrës varet nga vet aciditeti i saj. Neutralizimi bëhet në disa mënyra, mirëpo ne, në kushtet tona, e bëjmë me kalcium oksid, i cili është si pluhur i bardhë. P.sh. i qesim në kade ujore 20 litra ujë, ndërsa në një vend tjetër e tresim një lugë kalcium oksid me një litër ujë dhe këtë pasi të fundërrohet ia derdhim dy herë ujin, (kalcium oksidi ia largon letrës aciditetin), pastaj i vendosim fletët me kujdes në ujë, në të cilin qëndrojnë 20-30 min., varësisht se sa janë të ndotura. Ato pastaj fërkohen ngadalë me dorë ose me brushë dhe u tërhiqen skajet. Pasi të qëndrojnë 20-30 min., kapen skajet e padëmtuara ngadalë, kthehen në një anë të skajit, që të kullohet uji, e pastaj qiten nga dy letra thithëse një fletë dhe kështu vazhdohet deri në fund. Pas 1-2 ore, ndërrohen letrat thithëse dhe këto vendosen në shtypës (presë) ku do të qëndrojnë 24-orë, që të rrafshohen mirë. Nëse ngjitet ndonjë pjesë e letrës thithëse, ajo mund të hiqet duke e fërkuar ngadalë me gomë, ndërsa nëse ngjitet më shumë, ajo mund të hiqet vetëm nëse qëndron një kohë të gjatë në ujë për 2 ose tri ditë.

*Restaurimi me dorë* - çdo herë para restaurimit e bëjmë përgatitjen e ngjitësit (ne, në rastin tonë, si ngjitës e përdorim nishesten, edhe pse e dimë se nuk aq e përshtatshme).

Përgatitja bëhet në këtë mënyrë: merren dy kupa (të kafes) me ujë të ftohtë dhe qiten për t'u vluar. Në një enë tjetër treten dy lugë (të sheqerit) nishesteme ujë, kurse në një vend tjetër




merren 2 gr xhelatin dhe qitet që të bymehet. Pasi që të vlojë uji, qitet nishesta e tretur, 2 gr timol (timoli ka veti dezinfektuese) - e hollon ngjitësin dhe nuk e lejon ngjitësin që të bëhet me kokrra. Timoli duhet të mbështillet me folje alumini, sepse është i ndjeshëm në dritë dhe mund të avullohet), dhe xhelatinë (xhelatina formohet nga xhelatina e eshtrave të shtazëve). Masa e formuar duhet të zihet 5 min., dhe gjatë zierjes përzihet që të mos ngjitet. Pas zierjes, ngjitësi i formuar mbulohet me një gazë dyfishe të lagur në ujë, në mënyrë që gjatë ftohjes, të mos bëhet si kore, dhe pastaj lihet që të ftohet. Pas ftohjes, kullohet në gazë të dyfishtë, që të hollohet (të mos mbeten kokrra) e pastaj përdoret për restaurim me dorë.

Pas çdo restaurimi dhe neutralizimi duhet të bëhet edhe rrafshimi i fletëve në presë (shtypës).

Varësisht se me çfarë materiali kemi të bëjmë, përdorim edhe metodat e restaurimit. Mirëpo, gjithmonë duhet nisur nga principi që të mos kryhet asnjë proces që e dëmton materialin. Është mirë që gjithmonë restaurimi i lëkurës të bëhet me lëkurë, i pergamenit me pergamenë, i letrës me letër dhe, në këtë kontekst - mundësisht të bëhet edhe përshtatja e ngjyrave. Gjatë restaurimit të materialit të rrallë, nuk guxon që të humbet asnjë grimcë qoftë edhe një shkronjë e vetme.

Restaurimi me dorë, varësisht se çfarë dëmtimi ka, bëhet, në qoftë se kemi vetëm një pjesë të vogël të fletës për ta restauruar, në tavolinën për restaurim. Aty e ndezim dritën dhe varësisht se çfarë ngjyre ka letra ose çfarë trashësie ka, bëhet edhe përzgjedhja e letrës japoneze. Prerja e letrës japoneze për restaurim bëhet mundësisht 1mm më tepër se sa është e dëmtuar letra. Ka raste kur fleta është shumë e dëmtuar dhe bëhet restaurimi i tërë fletës p.sh.: e pastrojmë tavolinën restauratore me ujë me vatë, ose me shpuze, dhe e qesim një najlon (polietilen 0,03mm), duke e bërë shtrirjen e tij dhe largimin e rrudhave, sepse ato mund ta rrudhin fletën. Po ashtu, laget edhe fleta në të dy anët; të lagurit e fletës duhet të bëhet nga mesi, duke shkuar skajeve me kujdes, në mënyrë që fleta të shtrihet mirë dhe të mos rrudhet. Pastaj fleta lyhet me ngjitës dhe, po ashtu, edhe lyerja e fletës me ngjitës bëhet nga mesi anash në formë ylli dhe lehtë me brushë. Mbi ngjitës qitet letra japoneze dhe mbi të prapë qitet najloni; mbi najlon qitet letra thithëse dhe hollohet lehtë, që të mos mbetet asnjë rrudhë. Ngjitja duhet të bëhet së paku 1cm jashtë fletës, që të jemi të sigurte për rregullimin e mirë të skajeve. Pastaj e heqim letrën thithëse dhe e rregullojmë fletën që më parë e kemi bërë si "senduiq", pastaj e rrotullojmë najlonin dhe e bëjmë restaurimin edhe në anën tjetër të fletës njësoj. Pas restaurimit të fletës në të dy anët, e qesim që të teret në raftet për terje 2-3 orë dhe më vonë e fusim në mes të letrave thithëse dhe e fusim në presë. Në presë, për ta futur, duhet të vendoset një fletë me dy letra thithëse. Po këtë procedurë të restaurimit e përdorim edhe për restaurimin e kopertinave të buta. Pas restaurimit bëhet prerja e skajeve të tepërta. Dhe me këtë, përfundon procedura e restaurimit me dorë – sipas metodave klasike, të aplikueshme në kushtet tona.

Laminimi zakonisht bëhet te fletët, të cilat janë shumë të thyeshme për shkak të shtimit të aciditetit e që varet nga kushtet në të cilat ka qëndruar ajo libër, por edhe nga kualiteti i letrës.

# Veprimtaria bibliotekare në Luginën e Preshevës gjatë viteve 1947 - 2005

XHEMALUDIN SALIHU

## HISTORIK

Fillet e veprimtarisë bibliotekare në Preshevë datojnë qysh në shekullin XIX, kur në qendër të qytetit ekzistonte biblioteka me leximore, e cila kishte koleksione të pakta të librave, si dhe disa gazeta e revista.

Pas Luftës së Dytë Botërore, format e para të përhapjes së librit ishin libraritë në pronësi shtetërore, ku pos shitjes së librave, ato kryenin edhe përhapjen dhe propagandimin e librit. Kishin vetëm libra në gjuhën serbe.

Gjatë viteve 1946-'47 formohen klubet e punëtorëve me grupet e lexuesve, të cilët nxitnin përhapjen e librit dhe të leximit. Librat dhe shtypi ishin në gjuhën serbe. Në këtë kohë, bibliotekat ishin të vendosura në lokalet e shkollave dhe në to kryesisht punonin mësuesit e shkollave.

Në vitin 1948, për herë të parë, në Preshevë fillon aksioni për blerjen e librit shqip. Sipas shënimeve të gjetura, në Preshevë, për herë të parë, libri shqip blihet në vitin 1964.

Gjatë viteve 1956-1965, veprimtarinë bibliotekare e karakterizon ekzistimi i bibliotekave personale-familjare, të cilat luanin rolin dhe funksionin e bibliotekave publike. Ato dhanë kontribut të madh kombëtar në ngritjen e nivelit arsimor dhe kulturor të popullatës së Preshevës. Pos të tjerave, më e njohura ishte ajo e arsimdashësit nga Presheva, Adem Ahmetit.

Në Preshevë, më 1965 themelohet Biblioteka Publike "Presheva", e cila më 1966 shndërrohet në bibliotekë amë, që, si e tillë funksionon edhe sot.

Më 1972 hapen degët e bibliotekës amë në Rahovicë, në Miratoc, në Leran dhe në Caravajkë. Në vitin 1975, biblioteka amë e Preshevës ka nënshkruar kontratë me Shtëpinë Botuese "Rilindja", me ç'rast i siguron të gjitha botimet e kësaj shtëpie botuese në gjuhën shqipe, pastaj të shtëpive botuese nga Maqedonia dhe nga Mali i Zi, si dhe botimet nga Shqipëria. Kjo kontratë ndërpritet në vitet 1989-'90.

Biblioteka amë, në periudhën 1969-1980, punoi dhe veproi në lokalet e ndërtesës së vjetër të Universitetit të Punëtorëve, në kuadër të të cilit ishte njësi punuese. Lokali i saj kishte sipërfaqe 36 m2 dhe nuk kishte sallë leximi. Që nga viti 1981, biblioteka kalon në lokalet e Shtëpisë së Kulturës, ku edhe sot vepron dhe punon, në sipërfaqe 150 m2, pa sallë leximi dhe e pandarë në sektor të punës. Fillimisht, në bibliotekën amë ishte i punësuar vetëm një librar, më vonë një librar dhe bibliotekar, ndërsa që nga viti 1995 aty punojnë pesë punonjës bibliotekarë, një librar dhe katër bibliotekarë.

Në Bujanoc, gjatë vitit 1946, ekzistonte një librari në pronësi private, e cila e kryente funksionin e bibliotekës në përhapjen e librit te popullata e kësaj komune. Po këtë vit, organizohen libraritë shëtitëse, të cilat pos që kishin karakter shitës të librit, ato, gjithashtu popullarizonin dhe propagandonin librin, duke shkuar nëpër fshatrat e Bujanocit. Koleksionet e kësaj librarie ishin në gjuhën serbe, ndërsa lloji i literaturës, marksiste-leniniste.

Shënimet arkivore flasin se në Bujanoc, në vitin 1946 -'47, ekzistonte biblioteka e qytetit, ndërsa si institucion i pavarur bibliotekar themelohet në vitin 1995, sipas Ligjit për Bibliotekat. Lokalet e para të bibliotekës kanë qenë në ish-ndërtesën e kinemasë në Bujanoc, afërsisht në vendin, ku gjendet sot godina e re e Shtëpisë së Kulturës. Kjo bibliotekë e zhvillonte veprimtarinë e saj në kuadër të Universitetit të Punëtorëve në lokale, shumë të ngushta. Kjo bibliotekë, tash e zhvillon veprimtarinë e vet në godinën e re të Shtëpisë së Kulturës, në të cilën ka kaluar në vitin 1982. Biblioteka nuk është e ndarë në sektorë të punës, por ka lokale të kënaqshme, me sallë leximi, ku anëtarët dhe qytetarët e Bujanocit mund të lexojnë shtypin e përditshëm dhe atë periodik.

Në Tërnoc ekzistonte një bibliotekë, në kuadër të së cilës ishte një leximore, dhe puna zhvillohej në lokalet e shkollës. Koleksionet e saj ishin të përbëra prej 19 librave, dy gazetave dhe një reviste. Po ashtu, edhe në fshatrat Bilaç, Breznicë, Lluçan, Letovicë, Nasalcë, Muhoc, Samolicë, Turi ekzistonin bibliotekat me apo pa leximore, por me koleksione të varfëra të librave.

Gjatë vitit 1948, biblioteka në Tërnoc nuk kishte lokal, por strukturat e Bashkësisë Lokale u angazhuan që ta zgjidhin çështjen e lokalit. Këtë vit filloi të shpërndahet edhe shtypi në gjuhën shqipe: Pionieri dhe Flaka e Vëllazërimit. Gjatë viteve 1953-'54, u themelua biblioteka e rrethit me seli në Bujanoc. Në Tërnoc, biblioteka u themelua në vitin 1970. Ndërkaq, në këtë kontekst, historia e veprimtarisë bibliotekare në Medvegjë nuk është dhënë, për shkak të mungesës së të dhënave (ato pak të dhënat që dalin për veprimtarinë bibliotekare shqiptare në Medvegjë, janë të siguruara para luftës).

## INFRASTRUKTURA DHE GJENDJA E KOLEKSIONEVE TË BIBLIOTEKAVE NË LUGINËN E PRESHEVËS

Në komunën e Preshevës, veprimtarinë bibliotekare e kryejnë biblioteka amë në Preshevë, degët e saj në Rahovicë, në Miratoc, në Leran dhe në Caravajkë, Biblioteka e Shkollave të Mesme "Presheva", Biblioteka e Shkollës Fillore "15 Nëntori", Biblioteka e Shkollës Fillore në Corroticë, Biblioteka Private "Dhurata" në Tërnavë, Biblioteka Islamike në Preshevë dhe disa biblioteka familjare.

Tashti, biblioteka amë punon në lokalet e reja në Shtëpinë e Kulturës, njësi e së cilës është që nga themelimi i saj. Tentativa e parë për pavarësimin e saj u bë në vitin 1996, pas nxjerrjes së Ligjit për Bibliotekat, sipas të cilit, bibliotekat duhet të pavarësoheshin nga shtëpitë dhe qendrat e kulturës dhe nga universitetet e punëtorëve. Mirëpo, edhe pse ligji aplikoi afatin e themelimit të bibliotekave, kjo pati sukses vetëm në Bujanoc, ndërsa në Presheve nuk kaloi.

Në vitin 1995 u formuan koleksionet e vendit në bibliotekën amë, ku gjendet material arkivor, publikime të shumta dhe literaturë mbi Preshevën, të autorëve të Preshevës me rrethinë dhe të atyre që kanë shkruar për Preshevën, sepse detyrë primare e koleksioneve të vendit janë



pasurimet arkivore, publicistike, shkrime, të dhëna, dokumente mbi Preshevën me rrethinë. Tashti, fondi i përgjithshëm i koleksioneve është rreth 19.000 tituj me 62.000 libra dhe publikime të tjera. Koleksionet janë të përpunuara në mënyrë profesionale, sipas Klasifikimit Universal Decimal. Biblioteka ka Skedarin Alfabetik dhe atë Sistematik. Koleksionet kryesisht janë në gjuhën shqipe, por edhe në serbe, bullgare, angleze dhe rome.

Biblioteka dhe koleksionet e saj janë të hapura dhe publike për përdoruesit, kështu që koleksionet e beletristikës jepen në lexim, ndërsa ato shkencore lexohen në bibliotekë, ose jepen me garanci për kthim. Në bibliotekë anëtarëson deri 1.400 lexues.

Biblioteka në Rahovicë ka lokalin e ri dhe modern, në ndërtesën e Bashkësisë Lokale dhe koleksionet e saj janë në gjuhën shqipe. Ato numërojnë 10.270 vëllime. Biblioteka në Caravajkë kishte koleksionet prej 7.400 librash, mirëpo për shkak të moskujdesit, ato u shkatërruan dhe biblioteka pushoi së punuari në vitin 1986. Në Miratoc, biblioteka ka koleksionet prej 8.300 librash, është e vendosur në lokalet e shkollës fillore. Kurse, biblioteka në Leran ka koleksionet prej 13.200 librash dhe është e vendosur në lokalet e shkollës fillore. Biblioteka e Shkollave të Mesme ka koleksione prej 14.400 librash. Ajo e shkollës fillore në Preshevë ka koleksionet prej 10.800 librash. Biblioteka e shkollës fillore në Corroticë ka 2.900 librash. Biblioteka private "Dhurata" në Tërnavë u themelua nga vëllezërit Zylfiu dhe koleksionet e saj përbëhen prej 3.400 librash.

Biblioteka e Bujanocit me degët e saj në Tërnoc dhe në Muhoc ka koleksionet prej 54.424 njësish. Biblioteka e qytetit i ka 38.100 njësi, prej tyre 34.000 në gjuhën serbe, kurse në gjuhën shqipe vetëm 4.100. Koleksionet në gjuhën shqipe u pasuruan në dy vitet e fundit. Biblioteka e Tërnocit përmbëhet prej 7.980 njësish, kurse ajo e Muhocit 8.360 ekzemplarë në gjuhën shqipe.

Numri i lexuesve është rreth 400, ndërsa i përdoruesve rreth 1 000. Biblioteka pos aktiviteteve bibliotekare zhvillon edhe aktivitete kulturore-arsimore, organizon mbrëmje letrare, promovime librash, ekspozita të librave, si dhe aktivitete të tjera kulturore.

Në Medvegjë ekziston biblioteka komunale, e cila ka pak koleksione në gjuhën shqipe. E njëjtë është gjendja edhe në bibliotekën e Banjës së Siarinës, ku jetojnë shqiptarët.

Ndërsa, biblioteka e Tupallës më herët (para luftës) kishte koleksione prej 700-800 njësish, ndërsa ajo e Banjës së Siarinës kishte 3 000 - 4 000 njësi; bibliotekat shkollore të Tupallës dhe të Banjës së Siarinës, si dhe biblioteka e qytetit, kishin koleksione prej 7 000 njësish në gjuhën shqipe, të cilat përfshinin botime të vjetra dhe lekturë shkollore; për fatin e këtyre koleksioneve bibliotekare nuk dihet asgjë pas luftës.

## DISKRIMINIMI NDAJ KULTURËS SHQIPTARE DHE LIBRIT SHQIP

Në Preshevë, dhuna ndaj bibliotekave dhe librit shqip fillon qysh në vitet e 50-ta, kur filloi fushata e diskriminimit. Nga koleksionet e bibliotekës u hoqën librat që ishin blerë para Rezolutës së Infobyrosë gjatë viteve 1951-52. Dhunën, censurimin dhe diskriminim e librit shqip e paralajmëroi një funksionar i lartë serb, më 1981, kur para punonjësve arsimorë të Preshevës dhe të Bujanocit u deklarua se ka dëgjuar që librat e autorëve nga Shqipëria gjenden në depo të bibliotekës dhe se ato duhet të zhduken. Këto fjalë ishin vetëm sinjal i një fushate të gjatë kohore kundër vlerave kulturore shqiptare, në veçanti, kundër librit shqip. Kështu në qershor të vitit 1981 u hoqën nga bibliotekat e Preshevës shumë tituj të teksteve dhe të doracakëve shkollorë. Urdhëresa kishte të bënte me të gjithë librat e autorëve të botuar në Shqipëri, mirëpo fal angazhimit të udhëheqjes komunale dhe të Shtëpisë së Kulturës, aksioni nuk u realizua plotësisht. Më 1987, përsëri, nga bibliotekat u konfiskuan 358 tituj me 3.287 njësi.

Në Bujanoc, gjatë vitit 1987 u bë ndalimi i librave shqip dhe që nga atëherë ato janë nën 'embargo' dhe nuk jepen në përdorim. Këtu është fjala për dhjetëra tituj të shkrimtarëve shqiptarë, siç janë Kadare, Agolli e shumë të tjerë. Të theksojmë se për shkak të luftës nuk dihet fati i librave të bibliotekave në Muhoc e Zarbincë.

# Manifestimi tradicional „Java e Bibliotekës në Kosovë"

Për herë të tretë me radhë, prej 11 deri më 18 prill, u mbajt manifestimi tashmë tradicional *Java e Bibliotekës në Kosovë,* e organizuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Zyra Amerikane në Prishtinë. Në fjalën solemne të drejtorit të BKUK-së, u tha se ky manifestim koincidon me Javën e Bibliotekës në Amerikë dhe, në këtë kontekst u vlerësua lart kontributi i Zyrës Amerikane në Prishtinë, e cila ka ndihmuar në konsolidimin e këtij institucioni të lartë kombëtar. Në këtë aktivitet të rëndësishëm, morën pjesë personalitete të shquara vendore e ndërkombëtare nga lëmi i kulturës, e në veçanti i bibliotekarisë. Aktivitet e Javës së Bibliotekës, përveç në BKUK, u zhvilluan edhe në bibliotekat regjionale të Gjilanit dhe të Prizrenit. Edhe kësaj radhe pati aktivitet të larmishme nga fusha e bibliotekarisë, por edhe e kulturës e historisë, për të cilat pati një interesim të madh. Patën vlerë të rëndësishme ligjëratat, sesionet dhe debatet për automatizimin dhe menaxhimin e ndryshimeve në sistemin bibliotekar, të cilat u udhëhoqën nga dy ekspertë të shquar amerikanë të fushës së bibliotekarisë - Stephen Short dhe Irene Owens. Këto ligjërata u ndoqën me mjaft interesim nga udhëheqës te departamenteve të BKUK-së dhe drejtues të bibliotekave në Kosovë, të cilët u njohën me përvojat dhe me të arriturat e bibliotekarisë. Interesim të veçantë zgjoi edhe ligjërata e ambasadorit Taher Khalifa, përfaqësues i Bibliotekës së Aleksandrisë nga Kajroja, me temën: *„Biblioteka e Aleksandrisë, e kaluara dhe e tashmja"*, pastaj ajo e ligjërueses nga Austria, Mary Sommers Pierce, me temën: *„Roli i bibliotekarëve në epokën e informacionit"*, si dhe ligjërata e zëvendës-drejtoreshës së Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Etleva Domi, me temën: *„Bibliotekat shqiptare në epokën e informacionit dhe teknologjive të reja"*.

Në kuadër të Javës së Bibliotekës në Kosovë, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës u hap Depozitura e Bibliotekës së NATO-s, ku në ceremoni morën pjesë përfaqësuesit politikë dhe ushtarakë më të rëndësishëm të vendit, ndërsa mysafir special ishte Xhejmi Shia. Me rastin e hapjes së Depozitures së NATO-s, interesim të veçantë pati edhe për ligjëratën e drejtorit të Bibliotekës së NATO-s, z. Jean Arthur Creff *„Zhvillimet më të fundit të NATO-s"*, si dhe ligjëratën: *„Hyrje në formatin MARC"*.

Në kuadër të kësaj Jave u hap edhe Arkivi i Shkrimtarëve, si dhe u bë promovimi i zërit të Fan Nolit.

Përveç aktiviteteve nga lëmi i bibliotekarisë, kjo Javë u shoqërua edhe me disa aktivitete të tjera, si: Ekspozitë e artit figurativ me piktoret Miradije Ramiqi dhe Valdeta Vuçiterna; Ekspozitë e fotografive: *„Prishtina e Vjetër"*, përgatitur nga Enver Rakovica; Ekspozita me botime të botuesve kosovarë: Faik Konica, Buzuku, Dukagjini dhe Libri shkollor, si dhe promovimi dhe ekspozita me botimet e BKUK-së, për të cilat referoi Mr. Tahir Foniqi.

Në kuadër të këtij manifestimi, u mbajt edhe Ekspozita Ndërkombëtare e Librit, që u realizua nga zyrat e huaja ndërlidhëse që veprojnë në Kosovë - amerikane, suedeze, franceze, japoneze dhe Programi Finlandez për të Drejtat e Njeriut.

Mbajtja e sesionit shkencor kushtuar 600-Vjetorit të lindjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, në kuadër të aktiviteteve të "Javës së Bibliotekës", shpalosi edhe shumë detaje për figurën emblematike të historisë së shqiptarëve – Skënderbeun. Në këtë sesion, me ligjëratat e tyre u prezantuan studiuesit e njohur: Prof.Dr. Jahja Drançolli, Dr. Ymer Jaka, Dr. Shyqri Nimani dhe Dr. Rexhep Munishi.

Në kuadër të Javës u mbajt Orë letrare nga PEN QENDRA e Kosovës, si dhe koncert me vepra artistike nga nxënësit e Shkollës së Mesme të Muzikës „Prenk Jakova".

Ligjërata që u mbajtën në Gjilan nga ekspertët amerikanë dhe tryeza e mbajtur në Prizren, e organizuar nga BKUK-ja, Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës dhe Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit, me temën *„Gjendja e bibliotekave publike 1990-2005"*, dhanë një kontribut të veçantë për të ndriçuar shumë probleme të perspektivave të fushës së bibliotekarisë.

**Përgatiti: Izet Abdyli**

# Ekspozita ndërkombëtare e librit në "Java e Bibliotekës"

Në kuadër të manifestimit "Java e Bibliotekës", u mbajt edhe Ekspozita Ndërkombëtare e Librit, që u realizua nga zyrat e huaja ndërlidhëse që veprojnë në Kosovë - amerikane, suedeze, franceze, japoneze dhe Programi Finlandez për të Drejtat e Njeriut, në fund të së cilës, librat e ekspozuara iu shpërndan falas të interesuarve. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm mysafirë të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe studentë. Përfaqësuesit e këtyre zyrave, me rastin e hapjes së kësaj ekspozite - prezantimit të kulturave të vendeve të tyre, u paraqitën me fjalime, duke dhënë edhe informacion të rëndësishëm për kulturat përfaqësuese, por dhe për materialet që prezantuan gjatë kësaj ekspozite.

### SVETLANA BRECA (ZYRA AMERIKANE)

*Siç e shihni, në këtë kënd janë vendosur botime të ndryshme të zyrës së ShBA-së në Prishtinë, të cilat janë të publikuara në tri gjuhë: shqipe, serbe dhe atë angleze. Kjo do të thotë se botimet janë të dedikuara për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Botimet u përkasin fushave të ekonomisë, drejtësisë, shkencave politike, si dhe fushave të tjera të studimit. Botimet janë mjaft tërheqëse për studentët e Universitetit të Prishtinës, por edhe për universitetet private. Me këtë rast, ju informojmë se të gjithë të interesuarit, sidomos studentët, mund të vijnë në Zyrën Amerikane në Prishtinë të marrin broshura falas, për fushat e tyre përkatëse që u interesojnë, dhe nga të cilat mund të përfitojnë shumë. Po ashtu, ato broshura mund të gjenden edhe në Qendrën Amerikane, e cila gjendet në BKUK. Këto janë të gjitha produkte te Departamentit te Shtetit, Programeve Ndërkombëtare për Informim që janë praktike për përdorim për audiencën vendore - studiues, rini, zyrtarë qeveritarë dhe shume të tjerë në tema, duke filluar prej të drejtave të njeriut deri te letërsia bashkëkohore e Amerikës. Këto materiale fokusohen në një varg të gjerë të çështjeve të politikës së Amerikës dhe në historinë, kulturën dhe institucionet amerikane.*

### KARIN HERNMARCK (ZYRA SUEDEZE)

*Zyra Suedeze në Kosovë ka kënaqësinë që të marrë pjesë në "Javën e Bibliotekës në Kosovë". Në këtë ekspozitë, sot prezantojmë vendin tonë me botime të ndryshme, libra, broshura, revista, etj., që flasin për historinë, letërsinë dhe disa autorë suedezë, si dhe për personalitete të tjera të famshme të Suedisë. Jemi shumë të kënaqur që marrim pjesë për herë të dytë në këtë javë, sikur vitin e kaluar, sepse ky është rast i mirë për të hapur rrugë që të bëjmë shkëmbimin e informacioneve, sidomos nga fusha e letërsisë, mes nesh (Suedisë) dhe jush (Kosovës). Për të gjithë ata që dëshirojnë të marrin edhe informacione të tjera, përveç këtyre që janë ofruar, apo thënë më mirë, për ata që dëshirojnë të dinë më shumë për Suedinë, atëherë ua rekomandojmë ueb faqen www.sweden.se, në të cilën mund të informoheni për shumë gjëra për Suedinë dhe letërsinë e saj. Ju falenderit shumë për pjesëmarrje.*

### TETSUYA TSUBOTA (ZYRA JAPONEZE)

*Është kënaqësi e veçantë që edhe Zyra e Japonisë në Prishtinë për herë të parë merr pjesë në këtë javë kulturore siç është Java e Bibliotekës në Kosovë. Konsideroj se kjo është një ngjarje e veçantë dhe e rëndësishme për Kosovën dhe për kosovarët, sepse është rasti ku mund të mësohet më shumë për Japoninë. Shpresoj se kjo do të jetë mundësi e veçantë komunikimi mes kulturës japoneze dhe kosovare. Tash dëshiroj t'ju tregoj disa fjalë për kul-*

turën japoneze. Populli japoneze vite të tëra ka marrë idetë e shumta nga vende të ndryshme, si nga fusha e teknologjisë ashtu edhe nga zakone dhe elemente të tjera kulturore. Jeta dhe stili i japonezëve tani janë kulturë tradicionale me influencë të kulturës aziatike dhe kulturës moderne perëndimore. Tash dëshiroj t'ju shpjegoj ceremoninë e çajit e cila quhet IKEBANA, që me fjalë të tjera do të thotë përgatitje lulesh. IKEBANA është prezantuesi më i mirë i kulturës japoneze. Ceremonia e çajit tradicional dhe IKEBANA, si forma arti, zbulojnë të vërtetën ndërmjet parimeve dhe zotërojnë rregullat e kënaqësive dhe formaliteteve. Ceremonia e çajit jep kuptimin e shpirtit të WABI-t (fjalë origjinale japoneze), që ka kuptimin e dëshirës për të qenë materialisht i thjeshtë dhe shpirtërisht i lirë dhe i mbushur. Sipas kësaj, gjatë ceremonisë së çajit, që të dy, sikurse mikpritësi ashtu edhe mysafiri, shijojnë momentin e pirjes së çajit, sikurse të ishte kjo rastësia e vetme në jetën e tyre.

Sa i përket ekonomisë japoneze, gjatë luftës së dytë botërore Japonia u shkatërrua tërësisht, ndaj ekonomia u ndërtua prej asgjëje. Japonia nuk posedon burime natyrore, përveç burimit njeri, kështu që arsimi gëzon prioritet në linjë të parë te ne.

### SAMJUEL RICHARD (ZYRA FRANCEZE)

Dëshiroj të prezantoj fillimisht politikën kulturore që ka Franca mes rrjetit diplomatik, në mënyrë të veçantë në fushën e librit. Duhet ditur se Ministria e Punëve të Jashtme e Francës, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës së Francës, zhvillon një politikë vullnetare për shpërndarjen e kulturës franceze, qoftë për fushën artistike, fushën e librit dhe fusha e audio-vizualeve. Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Shoqatave për Veprimtari Artistike, ndihmojnë ambasadat në forma të ndryshme që t'ua kryejë këto punë. Do të përmendja këtu Shoqatën e Veprimtarisë Artistike Franceze që ekziston që prej viteve '20. Ajo është e ngarkuar me një buxhet të çmuar në mënyrë që të qarkullojë jo vetëm vepra por edhe artisti. Aktivitetet mund të jenë të të gjitha fushave: vallëzim, pikturë, muzikë, teatër etj. Nëse flasim për librin "Ambasadat e Francës" ose më konkretisht, flasim për Zyrën Franceze në Prishtinë, mund të them se kjo zyre ka në dispozicion programe të ndryshme, siç janë: programet për ndihmën e botimeve që konsistojnë në ndihmën e punëve dhe veprave letrare ose shkencore, ose shkencave të tjera në gjuhën e vendit ku ndodhet ambasada ose zyra, në mënyrë që të ndihmojnë në shpërndarjen e kësaj vepre, por njëkohësisht të ndihmojë edhe botuesin, përkthyesin, sigurisht edhe lexuesin që do të ketë qasje në këtë vepër në gjuhën e tij. Ky program, që është i veçantë për librin dhe realizohet përmes Ministrisë së Kulturës së Francës, ndihmon edhe autorët e tjerë të huaj që jetojnë në Francë.

### SAHADETE LIMANI (FINNISH - OHCHR HUMAN RIGHT SUPPORT PROGRAMME - KOSOVA)

Së pari kisha dashur që në emër të Programit Finlandez për Përkrahje të të Drejtave të Njeriut të falënderoj

Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës për organizmin e këtij manifestimi dhe promovimin e këtyre e librave në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ky program ekziston në Kosovë që nga viti 1999, financohet nga qeveria finlandeze dhe zhvillohet në bashkëpunim me institucione dhe organizata vendore. Qëllimi kryesor i programit është ngritja e vetëdijes dhe promovimi i të drejtave të njeriut në shoqërinë kosovare. Në fillim të punës së tij, programi ka bërë një analizë të nevojave në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Rezultatet e kësaj analize, treguan se ekzistonte një mungesë e materialeve të botuara për të drejtat e njeriut në gjuhën lokale, gjë që shkaktonte pengesë në punën e avokatëve për të drejtat e njeriut, gjykatave lokale si dhe qytetarëve të Kosovës gjatë punës së tyre për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Prandaj programi vendosi që përveç të tjerash, një pjesë të madhe të punës ta fokusojë në përkrahjen e publikimeve në fushën e të drejtave të njeriut në gjuhët lokale në Kosovë. Që nga atëherë, pra nga viti 1999, Programi Finlandez për Përkrahjen e të Drejtave të Njeriut ka arritur të botojë 32 tituj në këtë fushë në formë librash, broshurash apo libra më të vegjël. Deri më tash kemi arritur t'i shpërndajmë mëse 30 mijë kopje falas nëpër institucione lokale, organizata joqeveritare, biblioteka, shkolla etj. Njëri nga partnerët kryesor, i cili na ka ndihmuar për shpërndarjen e këtyre materialeve të publikuara ka qenë Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, të cilës i jemi mirënjohës dhe e falënderojmë shumë.

sh.r.

## DEPOZITURA E BIBLIOTEKËS SË NATO-s

Më 8 prill në kuadër të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, u hap Depozitura e Bibliotekës së NATO-s. Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues politikë dhe ushtarakë të rëndësishëm të vendit, si: Ministri i Arsimit i Shkencës dhe i Teknologjisë - Agim Veliu, komandanti i KFOR-it - Iv dë Kermabon, komandanti i TMK-së - Agim Çeku. Mysafir special, me rastin e hapjes së kësaj depozite ishte edhe personalititei i shquar - Xhejmi Shia.




## LONDËR

Në kuadër të vizitës zyrtare, që pati në Londër, drejtori i BKUK-së, Dr. Sali Bashota, u takua edhe me koleksionaren e veprave të Skënderbeut, zonjën Patricia Nugge, nga Londra, e cila për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhuroi veprën "Historia për jetën dhe bëmat e Skënderbeut, princit të epirotëve" të Marin Barletit, historianit dhe kronistit më të saktë të figurës së heroit kombëtar të shqiptarëve. Kjo vepër, e cila deri më tash i përkiste koleksionit të Nugee-t, është e botuar në Augsburg, në shkurt të vitit 1533 (MDXXXIII). Vepra është përkthyer nga latinishtja në gjuhën gjermane nga Joanne Pinicianu. Kjo vepër është e shkruar në stilin gotik dhe është me ilustrime e fotografi të Skënderbeut, që janë të punuara nga piktori gjerman Breu the Elder, i cili jetoi në periudhën 1475-1537. Historia de vita et gestis Scanderbegi tashmë është pasuri e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

## "INTERNATIONAL BOOK PROJECT"

Organizata Joqeveritare "International Book Project" nga Lexington i SHBA-së, i ka dhuruar Kosovës kontingjentin me 15 mijë libra, të dedikuara për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe për Bibliotekën e qytetit të Gjakovës. Librat i takojnë shkencave mjekësore, teknologjisë informative, historisë, letërsisë, shkencave ekzakte, filozofisë, retorikës, ekonomisë, matematikës, shkencave kompjuterike etj. Kontribut të veçantë për këtë dhuratë ka dhënë Besnik dhe Ardena Gojani. Falënderime u janë dërguar edhe grupit tjetër – amerikanë, të cilët kanë dhënë kontribut në këtë donacion.

## "BIBLIOTHECA - RFID"

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka nënshkruar kontratën me kompaninë zvicerane "Bibliotheca - RFID", për implementimin e programit RFID me komponentët e tij, duke përfituar në shumë operacione të ndryshme të zhvillimit më të lartë teknologjik informativ dhe detektues. Tashmë, BKUK-ja është në procesin e pranimit të pajisjeve hardwerike dhe softwerike nga Zvicra, ndërsa ka filluar edhe procesi i parapërgatitjes për trajnime të stafit në softwer të ri.

## ULQIN & TETOVË

Në kuadër të zbatimit të projekteve të reja për zhvillimin e bibliotekarisë dhe krijimin e një rrjeti të zgjeruar bibliotekar me shtrirje të gjerë, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës u dhuroi institucioneve të rëndësishme kulturore në qendrat shqiptare në Mal të Zi (Ulqin) dhe në Maqedoni (Tetovë), një donacion me vlerë të veçantë, të nxjerrë nga fondi rezervë. Me këtë rast, Biblioteka e Universitetit Shtetëror të Tetovës u pasurua me tituj të ndryshëm librash, dhuratë nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, të cilët mbulojnë fusha nga më të ndryshmet shkencore, edukative, informative etj. Një dhuratë kësodore, këto ditë, iu dorëzua edhe Bibliotekës së Ulqinit, me ç'rast kjo bibliotekë u pasurua me 360 tituj, përkatësisht 600 ekzemplarë librash, që i takojnë fushës së letërsisë, të gjuhësisë, të informatikës, të mjekësisë, të filozofisë, të psikologjisë, të bibliotekarisë, etj. Librat e dhuruara janë në gjuhën shqipe, angleze, franceze, italiane etj. Këto donacione janë hap i parë në bashkëpunimin institucional në relacionin Prishtinë - Tetovë dhe Prishtinë - Ulqin, në shumë fusha kulturore dhe edukative.




## RUMANI

Më datën 24 qershor 2005, në Bibliotekën Kombëtare të Rumanisë, në Bukuresht, u nënshkrua Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekës Nacionale të Rumanisë. Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshje është krijimi i një ure bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy bibliotekave, për aktivitetet e tyre specifike, për objektivat e përbashkëta, si dhe për shkëmbimin e kulturave.

Kjo marrëveshje ka rëndësi mjaft të madhe, kur kihet parasysh fakti se Kolonia Shqiptare e Bukureshtit ka qenë ndër kolonitë më të frytshme në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, në fushën e veprimtarisë kulturore, në fushën e botimeve dhe të sferave të tjera kulturore.

## ZAGREB

Në Bibliotekën Kombëtare të Kroacisë u mbajt Paneli i Mitingut 13 të ISMN-së. Ishte ky takim i rregullt vjetor për ISMN-në, në të cilin mori pjesë edhe Kosova, në mesin e shumë shteteve pjesëmarrëse, si: Gjermania, Polonia, Kroacia, Hungaria, Lituania, Indonezia, Sllovenia, Spanja, SHBA-të, Franca, Çekia, Norvegjia, Anglia, Bosnja dhe Hercegovina etj.

Punimet e këtij takimi në nivel ndërkombëtar, janë zhvilluar në tri sesione. Në sesionin e parë, Dr. Hartmut Walravens, drejtor ndërkombëtar i ISBN-së / ISMN-së, paraqiti punën dhe angazhimet e Agjencisë Ndërkombëtare të ISMN-së në nivel botëror, për periudhën njëvjeçare.

Me këtë rast u bë e qartë se edhe struktura e ISMN-së prej vitit 2007 do të pësojë ndryshime, sikur në ISBN, nga 10 shifror do të bëhet 13 shifror. Dr. Walravens, duke folur për raportin financiar të ISMN-së, tha se kjo agjenci është duke praktikuar një fleksibilitet në procesin e anëtarësimit, ku disa shtete, që kanë ekonomi më të dobët dhe janë në fazë të zhvillimit, janë të liruara nga pagesa e anëtarësisë. Vlen të përmendet, në këtë kontekst, se Kosova ende është e liruar nga pagesa vjetore e anëtarësisë në këtë agjenci botërore.

## BIBLIOTEKAT NË KOSOVË DHE QASJA NË INFORMATA

Libri Bibliotekat në Kosovë dhe qasja në informata, e Vehbi Miftarit, rrok dy segmente, që janë dhe që funksionojnë si të pandashme; atë të lirisë së qasjes në informata dhe atë të bibliotekës si institucion, që respekton dhe punon për lirinë e qasjes në informata. Libri ndahet në dy pjesë: në pjesën e parë - me tekstet origjinale, dhe në pjesën e dytë kemi shtojcën e pesë deklaratave të ndryshme ndërkombëtare që mbrojnë lirinë e qasjes në informata. Pjesa e parë është më e rëndësishmja për synimet e bibliotekave në Kosovë, ku autori përmbledh studimet e tij për lirinë e qasjes në informata dhe atë liri e vë në relacion me gjendjen e bibliotekave në Kosovë dhe me aftësinë e tyre teknike e profesionale për t'u siguruar lexuesve një liri qasjeje në to. Normalisht, gjendja e bibliotekave në Kosovë nuk jep mundësi të mjaftueshme për realizimin, me përpikëri, të kësaj të drejte elementare përball një turme marrësish, që kërkon një gjë të tillë. Përballë kësaj gjendjeje, autori në libër paraqet kërkesa të reja, me të cilat mendohet të hiqen barrikadat e vëna, bibliotekave në Kosovës, në kuptimin e kapërcimit nga biblioteka tradicionale në ato elektronike. Pra, depërtimin sa më të shpejtë në këto informata, autori e sheh përmes ndryshimeve rrënjësore brenda bibliotekave tona, të cilat do t'i mundësonin nëpërmjet përdorimit të katalogut elektronik nga lexuesit. Pamundësia e zhvillimeve të tilla teknologjike nëpër biblioteka krijon vështirësi për plotësimin e nevojave të përdoruesve. Një gjë tjetër, që ndikon në ngecjen e realizimit të këtij detyrimi, autori e sheh edhe te stafi, që gjendet nëpër biblioteka, e që janë kryesisht me një përgatitje heterogjene e joprofesionale dhe që nuk janë në gjendje t'u shërbejnë lexuesve me një kualitet të duhur. Tejkalimet i sheh te mundësia për trajnimin e kuadrit bibliotekar nga ekspertë të bibliotekarisë.

## PROBLEMET E PËRGJITHSHME TË RUAJTJES DHE KONSERVIMIT TË MATERIALIT BIBLIOTEKAR

Një nga librat e rrallë me tematikë të veçantë është libri "Problemet e përgjithshme të ruajtjes dhe konservimit të materialit bibliotekar", i Bedrie Mekollit. Problemet e ruajtjes së materialeve të veçanta janë probleme me të cilat ballafaqohet bibliotekaria kosovare dhe që me vështirësi po ia del t'i tejkalojë. Hyrja e librit na tregon se "Qëllimi i këtij botimi është që të sigurojë informacione esenciale dhe praktike që janë të nevojshme, si dhe t'i ofrojë mundësi stafit bibliotekar dhe arkivor, jokonservator, të mbështesin një lloj kujdesi permanent, duke aplikuar programet ekzistuese të kujdesit të koleksioneve".

Libri në fjalë trajton dëmtime të materialeve, si: dëmtimet nga lagështia, myku, drita, insektet, etj. Libri sensibilizon, veçanërisht, opinionin bibliotekar, për rëndësinë që ka ruajtja dhe konservimi i materialeve të vjetra dhe të rralla, si dhe i fondit të përgjithshëm. Normalisht, kushtet e tashme, në të cilat vendosen librat, periodiku, muzikaliet etj. në bibliotekat e Kosovës janë jo të favorshme dhe ky libër u vjen si një ndihmë e madhe për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Në të kemi udhëzime të ndryshme për ruajtjen dhe restaurimin e materialeve, varësisht se prej çfarë dëmtuesi është dëmtuar materiali bibliotekar. Në libër përfshihen edhe standardet, që duhet të jenë, qoftë për restaurimin e materialit bibliotekar, qoftë për vendin dhe kushtet në të cilat duhet të ruhen fondet bibliotekare. Ky libër, me informacionin e përgjithshëm që ka, synon të jetë praktik, për t'i plotësuar nevojat elementare të atyre, që praktikisht janë të angazhuar në këtë punë – duke ofruar informacionin elementar, se si do të duhej vepruar me rastin e trajtimit të materialeve për ruajtje dhe restaurim. Kjo e bën librin me vlerë të veçantë në kushtet dhe rrethanat tona në Kosovë.

## JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË (19-24 PRILL 2004)

Java e Bibliotekës në Kosovë është njëri nga aktivitetet më të rëndësishme kulturore në Kosovë, që mbahen brenda vitit. Në këtë aktivitet, që tashmë ka nisur të bëhet tradicional, marrin pjesë, me punimet e veta, personalitete të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare, të cilët gjatë kësaj kohe trajtojnë probleme të rëndësishme të fushës së librit e të kulturës në përgjithësi. Duke pasur parasysh se trajtesat e tyre paraqesin një peshë të veçantë, ato, tashmë, çdo vit përmblidhen në libër - seri. Në këtë kontekst, edhe libri "Java e bibliotekës në Kosovë (19-24 prill 2004)", është përmbledhje e tërë ligjëratave që janë mbajtur gjatë kësaj Jave. Edhe në këtë libër përfshihen ligjërata të ndryshme – nga restaurimi e deri te format e ndryshme të organizimit dhe të menaxhimit të punës, brenda institucionit të bibliotekës. Me interes të veçantë janë ligjëratat e Sharon Fawcett, nga Biblioteka Presidenciale e SHBA-ve, me temën për bibliotekat presidenciale, ligjëratat e zonjës Karin Hermack për kulturën suedeze, ligjërata e Sophian K. Jordan për restaurimin e materialeve bibliotekare, si dhe i shumë autorëve vendës dhe të huaj. Ky lloj gërshetimi i autorëve, i teksteve dhe i përvojave të ndryshme, sjell tema interesante që komunikojnë gjatë me lexues.

**Muhamed ÇITAKU**